

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Brendshme
Zëvendësministri
Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz

**RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR
TRAFIKIMIT TË PERSONAVE
JANAR-DHJETOR 2012**

Tiranë, Mars 2013

PASQYRA E LËNDËS

I.	Ndjekja Penale	4
1.	Përmirësimi i kuadrit ligjor	5
2.	Lufta kundër përfshirjes së strukturave të zbatimit të ligjit në vepra penale që lidhen me trafikimin e personave.....	7
3.	Bashkëpunimi me vendet e tjera.....	7
4.	Tendencat e fenomenit, profili i trafikantit.....	9
5.	Të dhëna statistikore për hetimin dhe gjykimin e veprave penale të trafikimit të personave për periudhën janar – dhjetor 2012	10
	Të dhëna statistikore nga Policia e Shtetit	11
	Të dhëna statistikore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda	12
	Të dhëna statistikore nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.....	12
	Të dhëna statistikore nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda.....	13
	Të dhëna statistikore nga Gjykata e Lartë.....	13
6.	Rekomandime	14
II.	Mbrojtja dhe Asistenca ndaj viktimave të trafikimit	15
1.	Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit	15
2.	Identifikimi dhe Referimi i Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit	16
	Profili i Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit	17
	Identifikimi dhe Policia.....	17
	Identifikimi dhe Shërbimi Social Shtetëror dhe Shoqëria Civile.....	18
	Identifikimi dhe Drejtoria e Shërbimeve Konsullore, Ministria e Punëve të Jashtme.....	19
	Identifikimi dhe Inspektorati i Punës	19
3.	Mbrojtja e Viktimave të Trafikimit Dëshmitare	20
4.	Mbështetja e Viktimave të Trafikimit dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik në Mbrojtjen dhe Asistencën e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit.....	20
5.	Shërbimet e ofruara nga Koalicioni i Strehëzave Antitrafik.....	22
	Asistenca psiko-sociale/Këshillime:	22
	Asistenca ligjore:	22
	Asistenca mjekësore:	23
	Arsimimi:	24
	Kualifikime profesionale:	24
	Punësimi:.....	25
	Ndihma ekonomike:.....	25
	Ngritja dhe monitorimi i mikrobizneseve:.....	25
	Asistencë për fëmijët e përfitueseve	26
	Ndërmjetësim me familjen:.....	26
	Aktivitete sociale jashtë qendrës:.....	27
	Monitorimi dhe ndjekja e rasteve:	27
6.	Rekomandime	27
III.	PARANDALIMI.....	29
1.	Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor	29
2.	Ndërgjegjësimi publik.....	30

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

Aktivitetet ndërgjegjësuere të zhvilluara nga qendrat dhe organizatat partnere.....	31
3. Edukimi.....	32
4. Punësimi.....	33
Programet e krijimit të vendeve të reja të punës.....	33
5. Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të aktorëve që punojnë me kategoritë vulnerabël.....	33
6. Veprimtaria e Komiteteve Rajonale Antitrafikim (KRAT).....	36
7. Kryerja e kërkimit dhe mbledhja e të dhënave.....	39
8. Regjistrimi.....	40
9. Rritja e përfshirjes sociale të grupeve në nevojë dhe fëmijët në rrezik trafikimi.....	42
10. Promovimi dhe zbatimi i Kodit Global të Etikës dhe Kodit të Sjelljes në Turizëm.....	43
11. Rekomandime.....	43
IV. KOORDINIMI.....	44
1. KOORDINIMI I AKTORËVE ANTITRAFIK BRENDA VENDIT.....	44
a. Autoriteti Përgjegjës.....	44
b. Mekanizmi Kombëtar i Referimit.....	45
c. Komitetet Rajonale Antitrafik.....	45
d. Ngritja e kapaciteteve të aktorëve antitrafik	47
2. KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	48
V. Aneks 1.....	50
1. DISA SUGJERIME NË KUADËR TË PËRMIRËSIMIT TË LEGJISLACIONIT PENAL KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE DHE MBROJTJES SË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT.....	50
Instrumentet ndërkombëtarë dhe Kodi Penal Shqiptar.....	50
Lidhur me ndryshimet dhe shtesat në Kodin Penal.....	51
Lidhur me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale.....	56
Komente për ndryshime të tjera ligjore.....	58
VI. ANEKS 2.....	60
1. Ndërgjegjësimi dhe zgjerimi i rrjetit të aktorëve antitrafik.....	60
2. Ngritja e koordinuar e kapaciteteve të aktorëve antitrafik në aktivitetet ndërkombëtare.....	60

I. NDJEKJA PENALE

Lufta kundër trafikimit të personave vazhdon të jetë një ndër prioritetet kyçe të qeverisë shqiptare dhe të gjithë strukturave të tjera me detyra dhe përgjegjësi në këtë drejtim. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2012 ka patur zhvillime pozitive në drejtim të hetimit dhe gjykimin të veprave penale të trafikimit, veçanërisht në përmirësimin e kuadrit ligjor, rritjes së kapaciteteve të strukturave që merren me hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave, evidentimit të rasteve të reja, si dhe rritjes së bashkëpunimit me vendet e tjera.

Në drejtim të ndjekjes penale si zhvillime më të rëndësishme do të veçonim:

- **Propozimet për ndryshime në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.** Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave (ZKKA), prej disa vitesh tashmë është vënë në lëvizje për të bërë ndryshimet e nevojshme, si në Kodin Penal, ashtu edhe në Kodin e Procedurës Penale. Së fundi, kjo zyrë është bërë pjesë e grupeve të punës të ngritur nga Ministria e Drejtësisë dhe ka dhënë sugjerime konkrete, bazuar në eksperiencën disa vjeçare të të gjitha strukturave të përfshira në luftën kundër trafikimit të personave.
- Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe Njësia Antitrafik, që në fund të vitit 2011 ka iniciuar **ngritjen e një grupi pune për të diskutuar për çështje që kanë të bëjnë me hetimin dhe gjykimin e rasteve konkrete të trafikimit të personave.** Ky proces është finalizuar më datë 27 nëntor 2012 me firmosjen e Urdhrit të Përbashkët nga titullarët e Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë. Takimi i parë i grupit të punës është zhvilluar më datë 26.12.2012 dhe ka vijuar edhe me 4 takime të tjera gjatë muajve janar – mars 2013. Bazuar në analizën e bërë, grupi i punës do të hartojë një raport, në të cilin do të parashikohen edhe sugjerime konkrete për përmirësimin e hetimit dhe gjykimin të rasteve të trafikimit të personave, përfshirë edhe propozime për ndërhyrje në legjislacionin penal.
- **Ka patur një përmirësim të dukshëm në zbatimin e ligjit në drejtim të identifikimit të hershëm të rasteve të trafikimit,** duke u bazuar edhe në Procedurat Standarde të Veprimit¹. Është rritur numri i strukturave që marrin pjesë në identifikimin fillestar të viktimave të trafikimit dhe si rrjedhojë edhe mundësia për referimin e rasteve të reja për procedim penal.
- Gjatë periudhës janar – dhjetor 2012 ka patur një **bashkëpunim mjaft efektiv edhe me vendet e tjera,** si në drejtim të shkëmbimit të informacionit për llogari të hetimeve dhe gjykimeve, ashtu edhe në drejtim të përmirësimit të instrumenteve të bashkëpunimit dhe koordinimit me strukturat homologe. Këtu do të përmendim **11 operacionet e përbashkëta** të realizuara në bashkëpunim me strukturat homologe të policisë italiane dhe gjermane, si dhe nënshkrimin më datë 12 qershor 2012 të **protokollit shtesë të bashkëpunimit me Kosovën** “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër

¹ VKM Nr. 582 datë 27.07.2011 për miratimin e “Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit”

trafikimit të qenieve njerëzore dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të ndihmuar të viktimave, si dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në veçanti të fëmijëve”.

- Në drejtim të **rritjes së kapaciteteve** një rol të rëndësishëm zënë edhe **trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe Policia e Shtetit** në bashkëpunim edhe me organizatat ndërkombëtare. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2012, nga **Shkolla e Magjistraturës** janë zhvilluar **21 aktivitete trajnimi**², ndër të cilat **5 aktivitete** kanë trajtuar tema specifike mbi fenomenin e trafikimit, sidomos për kuadrin ligjor dhe aspekte të hetimit dhe gjyqimit. Në këto trajnime kanë marrë pjesë rreth 114 gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore. Gjatë vitit 2012, Policia e Shtetit në bashkëpunim me Njësinë Antitrafik në Ministrinë e Brendshme dhe me mbështetjen e disa donatorëve kanë organizuar disa trajnime me objekt trajtimin specifik të çështjeve të trafikimit të personave, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 500 specialistë nga policia e shtetit, shërbimi social shtetëror, shëndeti publik, arsimi dhe përfaqësues të OJF-ve aktive në luftën kundër trafikimit të personave.

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor

Koordinatori Kombëtar dhe Njësia Antitrafik në vazhdimësi ka punuar për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe afrimin e tij me standardet më të mira ndërkombëtare. Duke filluar që nga fundi i vitit 2011 dhe gjatë gjithë vitit 2012, është punuar për të identifikuar nevojën për ndërhyrje ligjore, duke reflektuar edhe rekomandimet dhe sugjerimet e organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë si ato të Këshillit të Evropës, Departamentit Amerikan të Shtetit, Komisionit Evropian etj. Njësia Antitrafik në Ministrinë e Brendshme ka hartuar një material paraprak duke identifikuar ndërhyrjet kryesore në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Ndryshimet e propozuara konsistojnë në rishikimin dhe përmirësimin e veprave penale të trafikimit, shtimin e disa dispozitave të reja në Kodin Penal, si dhe amendimin e Kodit të Procedurës Penale me qëllim rritjen e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit, mundësimin e përfaqësimit ligjor të viktimave të trafikimit, si dhe është hedhur ideja për hartimin e një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit të personave. Materiali i hartuar nga Njësia Antitrafik i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë dhe është ndarë edhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile³. Kemi mirëpritur iniciativën rishtazi të Ministrisë së Drejtësisë për ndryshime në Kodin Penal. Njësia Antitrafik, duke u bazuar në projektligjin e paraqitur nga MD, ka përcjellë nëpërmjet Ministrisë së Brendshme komente dhe sugjerime konkrete për përmirësimin e dispozitave të trafikimit të personave. Në ndryshimet e propozuara vlen të përmendet nevoja për shkrirjen e tre dispozitave të trafikimit në një nen të vetëm, si dhe qartësimin e përmbajtjes së dispozitës së trafikimit dhe disa elementë që kanë krijuar vështirësi në zbatimin e tyre në

² Më shumë informacion mbi trajnimet e zhvilluara do të gjeni në Kreun IV të Raportit që flet për Koordinimin

³ Përpara iniciativës së lartpërmendur të Ministrisë së Drejtësisë, nga Ministria e Brendshme në janar-shkurt 2012, propozime të ngjashme u bënë pjesë e diskutimeve në Komisionin e Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Këto propozime u vlerësuan në parim si të nevojshme, por u propozua që të rishikohen edhe njëherë me idenë e hartimit të një pakete të plotë ndryshimesh, bazuar edhe në një konsultim më të gjerë me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit dhe shoqërinë civile.

praktikë. Në projektligjin e fundit të MD janë propozuar edhe disa dispozita⁴ të reja që kanë lidhje me trafikimin e personave siç është *Përfshirja nga dënimi i viktimave të trafikimit; Kriminalizimi i përdorimit të shërbimeve të viktimave të trafikimit; Kriminalizimi i falsifikimit të dokumenteve me qëllim trafikimin e personave etj.* Në materialin e përgatitur nga Njësia Antitrafik janë marrë në konsideratë edhe disa sugjerime të grupit të punës për rastet e trafikimit të personave, i cili vazhdon akoma punën.

Duke marrë në konsideratë problematikat e shfaqura dhe të shprehura nga strukturat e zbatimit të ligjit gjatë hetimit të rasteve të trafikimit, si dhe bazuar në një proces të ngjashëm të zhvilluar me mbështetjen e ICITAP, me propozimin e Ministrisë së Brendshme, më datë 27 nëntor 2012 është finalizuar iniciativa për ngritjen e një grupi të përbashkët pune midis Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë. Qëllimi i ngritjes së këtij grupi pune është hartimi i një raporti bazuar në studimin e disa rasteve konkrete të trafikimit të personave. Raporti do të identifikojë vështirësitë dhe problematikat kryesore lidhur me hetimin dhe gjykimin e këtyre çështjeve, si dhe do të dalë me rekomandime konkrete për mbarëvajtjen e ndjekjes penale të këtyre çështjeve, përfshirë edhe sugjerime për përmirësimin e legjislacionit penal që rregullon këtë fushë. Pjesë e diskutimeve në grupin e punës janë edhe problemet dhe shqetësimet e ngritura nga partnerët të ndryshëm, përfshirë edhe ata ndërkombëtarë, dhe që kanë të bëjnë kryesisht me mënyrën e identifikimit të rasteve të trafikimit, sigurimin e provave, hetimin si dhe gjykimin e këtyre çështjeve, në veçanti rastet e trafikimit të brendshëm. Takimi i parë i grupit të punës është zhvilluar më datë 26.12.2012 dhe ka vijuar edhe me 4 takime të tjera gjatë muajve janar – mars 2013.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2012 janë miratuar disa **akte të tjera ligjore dhe marrëveshje** që prekin aspekte të veçanta të luftës kundër trafikimit të personave, kryesisht në drejtim të mbrojtjes së viktimave të trafikimit:

1. Nënshkrimi më datë 15 qershor 2012 të *Marrëveshjes së Rishikuar të Bashkëpunimit “Për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave (MKR)”*, ku do të veçonim përfshirjen në këtë marrëveshje edhe të Prokurorisë së Përgjithshme, si një aktor shumë i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të ndjekjes penale.
2. Në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, me nismë të Ministrisë së Drejtësisë është realizuar anëtarësimi në Protokollin e Katërt Shtesë të Konventës Evropiane “Për ekstradimin”, i cili është miratuar në parim me Vendimin nr. 602, datë 05.09.2012 të Këshillit të Ministrave dhe nënshkruar më datë 20.09.2012 nga Zëvendësministri i Drejtësisë. Ky Protokoll Shtesë parashikon rregulla të detajuara për ekstradimin e thjeshtuar, ku në këtë procedurë përfshihen edhe personat e dënuar apo akuzuar për vepra të ndryshme penale, përfshirë edhe trafikimin e qenieve njerëzore.

⁴ Materiali i plotë për dispozitat e propozuara nga Njësia Antitrafik gjendet në fund të raportit – Aneks 1 – Disa sugjerime në kuadër të përmirësimit të legjislacionit penal kundër trafikimit të personit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm është edhe miratimi i Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 387, datë 24.08.2012 “Për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit”, në zbatim të PSV-ve (VKM Nr. 582). Në këtë urdhër përcaktohen detyrat e Policisë Kufitare dhe Migracionit, të Policisë së Rendit dhe Sigurisë Publike për identifikimin fillestar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe detyrat e Policisë kundër Trafikeve të Paligjshme për identifikimin formal të tyre.

2. Lufta kundër përfshirjes së strukturave të zbatimit të ligjit në vepra që kanë të bëjnë me trafikimin e personave

Gjatë periudhës **janar – dhjetor 2012, nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB)** në Ministrinë e Brendshme, nuk është regjistruar **asnjë rast implikimi** i oficerëve të Policisë së Shtetit në veprimtari që kanë të bëjnë me trafikimin e personave, përfshirë edhe veprat penale që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e prostitucionit, si dhe shfrytëzimin e prostitucionit në rrethana rënduese (nenet 110/a; 114; 114/a; 114/b dhe 128/b të KP). Po ashtu as në **Prokurorinë e Krimeve të Rënda** nuk është referuar asnjë rast për përfshirje të strukturave të zbatimit të ligjit në veprimtari kriminale të trafikimit të personave. Edhe nga **Shërbimi Informativ Shtetëror**, për vitin 2012, nuk rezulton ndonjë informacion për përfshirje të strukturave të zbatimit të ligjit në veprimtari të trafikimit të personave.

3. Bashkëpunimi me vendet e tjera

Bashkëpunimi ndërkombëtar për luftën kundër trafikimit ka vazhduar të përmirësohet dhe të shënojë nivele të tjera zhvillimi sidomos me vendet e rajonit. Në vazhdimësi është shkëmbyer informacion me të gjitha vendet me të cilat janë të lidhura veprat e trafikimit të personave, vende të cilat shfaqen kryesisht si vende tranziti dhe destinacioni për viktimat shqiptare të trafikimit.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2012, Policia e Shtetit ka bashkëpunuar në **11 operacione të përbashkëta** me strukturat homologe të policive të vendeve të rajonit dhe më gjerë. 10 nga këto operacione janë realizuar në bashkëpunim me Policinë Italiane dhe 1 me Policinë Gjermane. Këto operacione kanë patur për qëllim goditjen e veprimtarisë kriminale të shfrytëzimit të prostitucionit, shfrytëzimit për prostitucion në rrethana rënduese dhe trafikimit të femrave (nenet 114, 114/a dhe 114/b të KP). Të gjitha raste janë referuar për procedim penal në Prokurori.

Në njërin prej bashkëpunimeve më të suksesshme me homologët e policive të shteteve të Gjermanisë, Belgjikës dhe Holandës është realizuar një operacion i përbashkët ndërkombëtar për të goditur trafikimin e qenieve njerëzore, duke çuar në arrestimin e 28 shtetasve shqiptarë që ushtronin aktivitetin e tyre të kundërligjshëm në këto shtete.

Operacione me Policinë Italiane:

- **2** operacione për veprën penale “shfrytëzimi i prostitucionit” - neni 114 i KP;
- **6** operacione për veprën penale “shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” - neni 114/a i KP;

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

- 2 operacione për veprën penale “trafikimi i femrave” - neni 114/b i KP;

Me Policinë Gjermane:

- 1 operacion për veprën penale “shfrytëzimi i prostitucionit” dhe 1 operacion për veprën penale “Prostitucioni” - nenet 114 dhe 113 të KP;

Në këto operacione janë identifikuar dhe arrestuar gjithsej **48 persona si autorë të veprave penale:**

- 30 autorë për veprën penale “shfrytëzimi i prostitucionit” - neni 114 i KP;
- 10 autorë për veprën penale “shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese” - neni 114/a i KP;
- 8 autorë për veprën penale “trafikimi i femrave” - neni 114/b i KP;

Lidhur me ekstradimet sipas informacionit të Policisë së Shtetit kemi këto të dhëna:

- **Ekstradime në vende të tjera për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe për shfrytëzim prostitucioni:**

Shtetet	Persona të ekstraduar për trafikim të qenieve njerëzore	Persona të ekstraduar për shfrytëzim prostitucioni
Itali	2	8
Serbi	1	
USA	1	
Belgjikë		1
Totali	4	9

- **Ekstradime nga vende të tjera për në Shqipëri për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe për shfrytëzim prostitucioni:**

Shtetet	Persona të ekstraduar për trafikim të qenieve njerëzore	Persona të ekstraduar për shfrytëzim prostitucioni
Itali		6
Greqi	1 (trafikim i të miturve)	1
Totali	1	7

Lidhur me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, sipas statistikave të administruara nga **Ministria e Drejtësisë** nëpërmjet Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, për veprat e trafikimit të personave gjatë vitit 2012, referuar neneve të Kodit Penal, rezultojnë këto të dhëna:

- Për veprën penale “trafikim i të miturve” – neni **128/b i KP:**

**Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012**

- Ekstradime nga jashtë - 2 kërkesa nga Greqia;
- Letërporosi për jashtë -1 kërkesë për Itali.

- Për veprën penale “trafikimi i femrave” – neni **114/b i KP**:
 - Ekstradime nga jashtë – 1 kërkesë nga Italia;
 - Letërporosi për jashtë - 1 për Francë, 7 për Greqi, 1 për Itali;
 - Njohje vendimi për jashtë – 1 për në Kosovë.

- Për veprën penale “trafikim i personave” – neni **110/a i KP**:
 - Letërporosi nga jashtë - 1 nga Belgjika, 1 nga Kosova;
 - Letërporosi për jashtë - 1 për Itali.

Më datë 12 qershor 2012 u nënshkrua **protokolli shtesë i bashkëpunimit me Kosovën** “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të ndihmuar të viktimave, si dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në veçanti të fëmijëve”. Ky protokoll shtesë vjen në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar” të nënshkruar në Prishtinë më datë 06.10.2009. Protokolli shtesë rregullon aspekte të veçanta të bashkëpunimit dypalësh me një qasje të veçantë ndaj fëmijëve. Synohet një rritje e bashkëpunimit midis Autoriteteve Përgjegjëse të palëve nënshkruese në drejtim të shkëmbimit të informacionit për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, sigurimit të zbatimit të akteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë, institucionalizimit të bashkëpunimit, caktimit të personave të kontaktit për shkëmbimin e informacionit, mbikëqyrjen dhe zbatimin e protokollit. Aktualisht, jemi në pritje të caktimit të personit të kontaktit nga pala kosovare.

4. Tendencat e fenomenit, profili i trafikantit

Bazuar në statistikat e rasteve të hetuara për trafikimin e personave, Shqipëria vazhdon të jetë ende vend origjine për viktimat e trafikimit⁵ me vende destinacioni në përgjithësi vendet e rajonit si Kosova, Greqia, dhe Italia, por edhe Belgjika, Holanda, Gjermania dhe Britania e Madhe.

Vajzat shqiptare shfrytëzohen për shërbime seksuale. Mënyra tradicionale e rekrutimit të tyre është ajo e ofrimit të punës si valltare nëpër lokale e bare të ndryshme dhe më pas përfshirja e tyre në aktivitetin e paligjshëm të prostitucionit. Ka patur edhe raste të mashtrimit për bashkëjetesë, fejesë, apo edhe një rast për bashkim familjar. Trafikimi realizohet nëpërmjet kalimit të ligjshëm të kufirit shtetëror duke shfrytëzuar qarkullimin e lirë pa viza. Megjithatë ka edhe raste të kalimit të paligjshëm të kufirit, kryesisht për t’iu shmangur kontrolleve të policisë. Vlen të theksohet se është vënë re edhe kryerja e martesave të rreme të vajzave shqiptare me shtetas të huaj (kryesisht serbë apo maqedonas) dhe herë pas here ka pasur indicje se ato mund të

⁵ Më shumë informacion për profilin e viktimave të trafikimit do të gjeni në Kreun II të këtij raporti që flet për Mbrojtjen

shfrytëzoheshin për prostitucion, por pas verifikimeve të kryera nga Policia në bashkëpunim edhe me homologët e Malit të Zi, Serbisë e Maqedonisë, ka rezultuar se këto raste nuk kanë të bëjnë me trafikimin e personave. Një fenomen që është vënë re kohët e fundit është shndërrimi i viktimave të trafikimit, kryesisht vajzave të shfrytëzuara për prostitucion, në bashkëpunëtore të ngushta të trafikantëve për rekrutimin e vajzave të tjera. Të miturit shfrytëzohen kryesisht për lypje brenda vendit, por ka patur dhe raste kur destinacioni i tyre ka qenë Kosova.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka patur edhe një rast trafikimi të dy shtetasve të huaj meshkuj nga Filipinet, të trafikuar në Kosovë dhe më pas në Shqipëri me qëllim shfrytëzimin për punë në restorante si kuzhinierë. Nga informacionet më të fundit rezulton se kjo çështje është regjistruar rishtazi në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe është në proces hetimi.

Përvoja e deritanishme e hetimit të veprave penale të trafikimit të personave ka treguar se viktimat e trafikimit kanë bashkëpunuar me prokurorinë për një hetim sa më të plotë dhe objektiv. Viktimat e trafikimit kanë shfaqur gatishmëri për të dhënë shpjegime sa herë që është parë e nevojshme për të sqaruar rrethana të caktuara të hetimit. Gatishmëria e viktimave për të ndihmuar prokurorinë është krijuar për shkak të bindjes që është formuar tek to se janë marrë masat e duhura dhe efektive për mbrojtjen e tyre.

Për sa i përket **profilin të trafikantit konstatohet** se ata u përkasin grup-moshave 25 – 40 vjeç, vijnë nga familje me probleme financiare, edukim të ulët arsimor dhe kryesisht janë nga veriu i Shqipërisë ose nga zona të thella malore të jugut dhe juglindjes. Një pjesë e tyre kanë jetuar jashtë shteti, aty ku zhvillojnë edhe veprimtarinë e tyre kriminale. Gjithashtu, është vënë re se trafikantët nuk përdorin më dhunë fizike dhe psikologjike për rekrutimin e viktimave, janë të pakta rastet kur një femër dhunohet ose mashtrohet për qëllime shfrytëzimi. Ka patur raste kur të dëmtuarat realizojnë marrëveshje me trafikantët për të punuar jashtë shtetit për qëllime prostitucioni.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2012 vërehet një rënie e tentativave për kalim të paligjshëm të kufirit nga shtetasit shqiptarë. Kjo situatë shpjegohet me krijimin e kushteve të shtetasve shqiptarë për lëvizje të lirë pas liberalizimit të vizave. Më konkretisht, për këtë periudhë, janë kapur **351 persona (nga këto 16 kanë qenë femra)** në tentative për kalim të paligjshëm të kufirit. Nëse tentativat nga brenda-jashtë kanë ardhur në rënie, vërehet **një rritje e konsiderueshme e shtetasve të huaj, që tentojnë të kalojnë kufirin nga jashtë-brenda**. Këto shtetas janë kryesisht nga vendet e Afrikës Veriore dhe Azisë, të cilët duan të kalojnë nëpërmjet Shqipërisë në vendet e zhvilluara të Evropës. Megjithëse këto raste nuk rezultojnë si raste trafikimi, mbështetur kjo nga fakti se Policia e Kufirit tregon kujdes të veçantë gjatë intervistimit të tyre.

5. Të dhëna statistikore për hetimin dhe gjykimin e veprave penale të trafikimit të personave për periudhën janar – dhjetor 2012

**Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012**

Të dhëna statistikore nga Policia e Shtetit

Spektori kundër Trafikeve të Paligjshme në Policinë e Shtetit, gjatë periudhës janar – dhjetor 2012, ka evidentuar **gjithsej 31 vepra penale** që kanë të bëjnë me trafikimin e personave. Nga këto, **26 vepra penale** për “Trafikim i femrave” – neni 114/b i KP; **2 vepra penale** për “Trafikim i personave” – neni 110/a i KP dhe **3 vepra penale** për “Trafikim i të miturve” – neni 128/b i KP. Për të gjitha rastet e përmendura më sipër janë evidentuar gjithsej **35 autorë** (30 për “Trafikim i femrave” – neni 114/b i KP, 2 për “Trafikim i personave” – neni 110/a i KP dhe 3 për “Trafikim i të miturve” – neni 128/b i KP). Nga 35 autorë që janë gjithsej, 8 prej tyre janë arrestuar, 1 është ndaluar, 23 janë proceduar në gjendje të lirë dhe 3 janë shpallur në kërkim.

Veprat e trafikimit të personave të evidentuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2012

Vepra Penale	Evidentuar	Autorët	Arrestuar	Gj. Lire	Kërkim	Ndaluar
Trafikimi i femrave	26	30	8	19	3	-
Trafikim i personave	2	2	-	2	-	-
Trafikimi i të miturve	3	3	-	2	-	1
SHUMA	31	35	8	23	3	1

Për periudhën janar – dhjetor 2012 nuk ka patur raste të trafikimit të brendshëm dhe kjo situatë është edhe pasojë e interpretimit të bërë në Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr. 3, datë 24.01.2011, i cili nuk pranon konceptin “trafikim i brendshëm”.

Megjithatë duhet të theksojmë faktin se të gjitha veprimet e paligjshme të kryera nga trafikantët, si shtytja apo ndërmjetësimi me qëllim shfrytëzimin e shtetaseve për qëllime prostitucioni, kur këto veprime janë kryer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë regjistruar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore si procedime penale për “shfrytëzim prostitucioni”, ose “shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese”. Kështu për periudhën janar – dhjetor 2012 janë evidentuar gjithsej: **41 vepra penale** për “Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese” – neni 114/a i KP, me 67 autorë nga të cilët 9 janë arrestuar, 33 hetohen në gjendje të lirë, 4 autorë janë shpallur në kërkim dhe 21 janë ndaluar dhe **28 vepra penale** për “Shfrytëzim prostitucioni” – neni 114 i KP, me 27 autorë nga të cilët 8 janë arrestuar, 14 ndiqen dhe hetohen në gjendje të lirë, 3 janë shpallur në kërkim dhe 2 janë të ndaluar.

Gjatë vitit 2012, nga Spektori kundër Trafikeve të Paligjshme në Policinë e Shtetit, janë realizuar me sukses 26 operacione, me 99 persona të implikuar, 91 prej te cilëve janë arrestuar/ndaluar, dhe 8 persona janë proceduar në gjendje të lirë. Nga këto:

- **3 operacione për “Trafikim i femrave”,** me 9 autorë të të arrestuar/ndaluar. Në njërin prej këtyre operacioneve është goditur edhe një **grup kriminal për “Trafikim i femrave”,** me 7 autorë të arrestuar.
- **23 operacione për “Shfrytëzim për prostitucion në rrethana rënduese, shfrytëzim për prostitucion, mbajtje e lokaleve për prostitucion dhe ushtrim prostitucioni”,** me 90 persona autore, 82 të arrestuar në flagrancë dhe 8 të proceduar në gjendje të lirë.

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2012 ka patur vetëm një rast të **hetimit pasuror** të një personi, i cili me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Shkallës së Parë është shpallur fajtor për veprën penale “Trafikim i femrave” - neni 114/b i KP.

Sipas informacionit të Ministrisë së Financave lidhur me pasuritë e konfiskuara gjatë vitit 2012 kemi këto vlera:

Lloji i pasurisë	Auto	Paluajtshme	Llog. Bank.	Biznes
Nr. i pasurive	1	6	11	3
Vlera në lekë	4,760,000	59,635,125	49,965,044	27,000,000

Duhet theksuar fakti se jo të gjitha këto pasuri janë konfiskuar me vendim të formës së prerë, pra jo të gjitha këto vlera kanë kaluar në pronësi të shtetit në mënyrë përfundimtare.

Në kuadër të përmirësimit të bazës ligjore për administrimin e këtyre pasurive, në fund të vitit 2012, është hartuar Manuali për Administrimin e Pasurive. Ky manual është hartuar me asistencën e ekspertëve spanjollë në kuadër të projektit të binjakëzimit “Mbështetje për strukturat kundër pastrimit të parave dhe krimeve financiare në Shqipëri”.

Të dhëna statistikore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2012, në Prokurorinë për Krime të Rënda janë **hetuar 30 procedime penale** që lidhen me trafikimin e personave, nga të cilat **13 raste të reja** të regjistruara gjatë vitit 2012 dhe **17 të mbartura** nga vitet e mëparshme (2009-2011). Sipas veprave penale, rastet e reja të regjistruara gjatë vitit 2012 janë: **9** vepra penale për “Trafikim i femrave” – neni 114/b i KP; **3** vepra penale për “Trafikim i të miturve” - neni 128/b i KP dhe **2** vepra penale për “Trafikim i personave” – neni 110/a i KP. Gjatë vitit 2012 nuk ka patur raste të trafikimit të brendshëm. Për të gjitha procedimet penale që lidhen me veprën penale të trafikimit të personave (*të regjistruara në vitin 2012 si dhe të mbartura nga viti 2009-2011*), në regjistrin e njoftimit të veprave penale janë regjistruar emrat e **11 shtetasve si autorë** të kryerjes së veprës penale (*persona nën hetim*). Të gjitha rastet e regjistruara në Prokurorinë për Krime të Rënda janë referuar nga Policia e Shtetit dhe të ndara sipas veprave penale janë si më poshtë vijon:

- **24** procedime penale (*12 të mbartura dhe 12 të reja të regjistruara gjatë vitit 2012*) për veprën penale “trafikim i femrave” neni 114/b i KP;
- **3** procedime penale të mbartura nga vitet e mëparshme për veprën penale “trafikim i të miturve” neni 128/b i K.P;
- **3** procedime penale (*dy të mbartura dhe një e re e regjistruar gjatë vitit 2012*) për veprën penale “trafikim i personave” neni 110/a i KP.

Të dhëna statistikore nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda

Të dhënat për çështjet e gjykuara nga **Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda (GJKR Shk.I)** rezultojnë si vijon:

- Ka **përfunduar gjykimi për 2 çështje** penale që i përkasin veprës së parashikuar nga neni 114/b i KP;
- Gjatë vitit 2012, është regjistruar vetëm **1 çështje e re**, për veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i K.P.;
- Aktualisht janë **në gjykim 2 çështje** penale, njëra për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i KP dhe tjetra për veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i KP;
- Nga dy çështje penale të përfunduara, janë **dënuar 2 persona** për veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i KP. Të pandehurit janë dënuar njëri me 10 vjet burgim dhe 4 milion lekë gjobë dhe tjetri me 15 vjet burgim dhe 6 milionë lekë gjobë.

Referuar informacionit të mësipërm, për çështjet e gjykuara nga **GJKR Shk.I**, për periudhën janar – dhjetor 2012, rezulton se rastet e trafikimit janë të trafikimit transnacional (jo trafikim i brendshëm) dhe vihet re një tendencë në ulje, krahasuar me vitin 2011. Në çështjet e gjykuara, shfrytëzimi ka qenë në formën e shfrytëzimit seksual. Viktimat e trafikimit (të dëmtuarat) kanë bashkëpunuar me drejtësinë, duke dhënë dëshmitë e tyre në proces. Proceset gjyqësore kanë zgjatur mbi një vit. Gjatë kësaj periudhe, në GJKR Shk.I, nuk ka patur raste të shqyrtimit të kërkesës së viktimave të trafikimit për kompensim gjatë procesit penal dhe nuk janë ngritur padi civile për këtë qëllim.

Të dhëna statistikore nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2012, **Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda (Gj.Ap.Kr.R)** ka trajtuar gjithsej **6 çështje** (5 prej tyre të regjistruara gjatë vitit 2012 dhe vetëm 1 e mbartur nga viti 2011) me objekt trafikimin e femrave, parashikuar nga neni 114/b i K.P (Nuk ka patur çështje për “trafikim i të miturve” – neni 128/b i KP) dhe as për “trafikim i personave” – neni 110/a i KP. Për **5 çështje ka përfunduar gjykimi** dhe për 4 prej tyre Gj.Ap.Kr.R ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKR Shk.I, ndërsa për 1 çështje është vendosur për mospranim ankimi. Nga të 4 çështjet e gjykuara rezulton se janë **dënuar gjithsej 7 autorë**. Dënimet e dhëna sipas vendimeve të Gj.Ap.Kr.R nuk ndryshojnë masat e dënimit të dhëna nga GJKR Shk.I dhe janë si më poshtë vijon:

- **1 i dënuar** me 10 vjet burgim;
- **4 të dënuar** me 10 vjet burgim dhe 4 milion lekë gjobë;
- **1 i dënuar** me 15 vjet burgim dhe 6 milion lekë gjobë;
- **1 i dënuar** me 16 vjet burgim.

Të dhëna statistikore nga Gjykata e Lartë

Në **Gjykatën e Lartë** rezulton se gjatë periudhës janar - dhjetor 2012 janë shqyrtuar gjithsej **24 çështje** të trafikimit të personave.

- **16 çështje për veprën penale “Trafikimi i femrave”** – neni 114/b i KP (nga këto, 8 janë të reja të regjistruara gjatë vitit 2012 dhe 8 të mbartura nga viti 2011). Nga këto janë gjykuar 5 çështje dhe 11 janë në pritje për gjykim;
- **8 çështje për veprën penale “Trafikimi i të miturve”** – neni 128/b i KP (nga këto 2 të reja të regjistruara gjatë vitit 2012 dhe 6 të mbartura nga 2011). Nga këto çështje janë gjykuar 2 prej tyre, ndërsa çështjet e tjera janë në pritje për gjykim.

Sipas informacionit më të fundit të Ministrisë së Drejtësisë numri i personave që vazhdojnë e vuajnë dënimet në burgjet shqiptare për veprat penale të trafikimit të personave (nenet 110/a, 114/b dhe 128/b të KP) është gjithsej **51 subjekte** (të dënuar):

- **35** të dënuar për veprën penale “trafikimi i femrave” - neni 114/b i KP;
- **15** të dënuar për veprën penale “trafikimi i të miturve” - neni 128/b i KP;
- **1** i dënuar për veprën penale “trafikimi i personave” - neni 110/a i KP.

6. Rekomandime

- Përmirësimi i bashkëpunimit midis strukturave të zbatimit të ligjit dhe krijimi i praktikave pozitive të koordinimit efektiv mes policisë dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, sidomos në drejtim të hetimit të çështjeve të trafikimit të personave dhe aseteve të tyre;
- Ngritja dhe vënia në funksionim e Fondit të Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit parashikuar në nenin 37 të Ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”;
- Unifikimi i statistikave, si në dhënien e shifrave, ashtu edhe në njehsimin e qëndrimeve për referimin e saktë të çështjes nga të gjitha strukturat e zbatimit të ligjit (Policia, Prokurori, Gjykata), sipas dispozitave të Kodit Penal për veprat penale të trafikimit të personave, të parashikuar në nenet 110/a; 114/b dhe 128/b të KP;
- Fokusimi tek trafikimi i brendshëm, në veçanti trafikimi i fëmijëve me qëllim shfrytëzimin për punë, lypje dhe prostitucion;
- Kryerja e studimeve lidhur me dinamikën e reja të shfaqjes së fenomenit të trafikimit të personave. Në fokus të këtyre studimeve të jenë mekanizmi i realizimit të trafikimit, format e reja të shfrytëzimit dhe profili i viktimës dhe trafikantit;
- Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të personave dhe përmirësimi i hetimit dhe gjyqimit të çështjeve të trafikimit të personave bazuar në një legjislacion të përditësuar dhe në përputhje me *acquis communautaire*;
- Finalizimi i iniciativave për përmirësimin e kuadrit ligjor bazuar në propozimet e bëra nga Koordinatorin Kombëtar kundër Trafikimit të Personave dhe Njësia Antitrafik.

II. MBROJTJA DHE ASISTENCA NDAJ VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar për të siguruar një mbrojtje dhe asistencë të garantuar për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Për të siguruar këtë objektiv tashmë po zbatohen dhe monitorohen *procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit (PSV)*, procedura të cilat sigurojnë një identifikim proaktiv të viktimave/viktima të mundshme të trafikimit dhe një referim të shpejt dhe të sigurt. Miratimi dhe zbatimi i PSV-ve, ka bërë të mundur institucionalizimin e hapave për sigurimin e identifikimit, referimit, rehabilitimit dhe ri integritetit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. **Zbatimi i PSV-ve ka rritur komunikimin, partneritetin dhe zhdërvjelltësinë e veprimeve mes anëtarëve të MKR-së.**

Njësia Antitrafik, dhe partnerët e saj kryesorë kanë bërë të mundur sigurimin e trajnimeve gjithëpërfshirëse lidhur me identifikimin dhe trajtimin e viktimave të trafikimit. Një kontribut të veçantë në këtë proces ka dhënë Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Trajnimet mbi zbatimin e PSV-ve janë shtrirë jo vetëm në strukturat e Policisë së Shtetit dhe Shërbimeve Sociale por dhe në agjenci arsimore, të shëndetit publik, inspektoratet e punës, etj.

Agjencitë shtetërore referuese kanë bërë të mundur referimin e të gjitha rasteve të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar. **Viktimat e trafikimit në Shqipëri tashmë përfitojnë kujdes shëndetësor falas**, një përpjekje e Njesisë Antitrafik, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Ministrisë së Shëndetësisë, qendrave⁶ antitrafik dhe MPCSShB. Institucionet shtetërore garantojnë mosburgosjen, gjobitjen e viktimave të trafikimit për veprimet e paligjshme që janë kryer si rezultat i drejtpërdrejtë i të qenit të trafikuar.

Qendrat që ofrojnë shërbime për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit kanë vazhduar dhënien e shërbimeve cilësore si akomodim, këshillim, riintegrim dhe monitorim. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë shërbime për 92 viktimat/viktima të mundshme trafikimi të identifikuar gjatë vitit 2012, prej të cilëve 26 fëmijë. Si viktimat trafikimi janë identifikuar 42 persona.

MPCSShB ka vazhduar financimin e qendrave. Qendrat kanë filluar gjithashtu të zhvillojnë idetë e biznesit shoqëror për të rritur mundësitë e vet-financimit dhe për të asistuar punësimin e viktimave të trafikimit.

1. Funksionimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit

Gjatë vitit 2012, Njësia Antitrafik finalizoi rishikimin e Marrëveshjes për Ngritjen e Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Rishikimi i Marrëveshjes ishte një proces i gjatë ku pjesëmarrja aktive e

⁶ Me qendra/strehëza kuptojmë : institucione të përkujdesit social rezidencial dhe/ose jo rezidencial, shtetëror ose jo shtetëror të licencuara sipas legjisllacionit në fuqi për të dhënë shërbime ndihme dhe mbrojtjeje për personat viktimat të mundshme të trafikimit, viktimat të trafikimit dhe persona në rrezik trafikimi.

anëtarëve⁷ të Mekanizmit, por edhe aktorë të tjerë antitrafik konkluduan në një dokument solid dhe të gjithë pranuar. **Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funkcionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave u nënshkrua më 15 Qershor, 2012.** Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është identifikimi, referimi, mbrojtja, ndihma e përmirësuar për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, si dhe ri-integrimi i tyre. Gjithashtu, kjo marrëveshje siguron më së miri zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit (PSV) të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 582, datë 27.7.2011, si pjesë e një qëllimi të përbashkët institucional kundër trafikimit të personave, rritjes së ndërgjegjësimit publik, si dhe përbushjes së detyrës shoqërore dhe morale të mbështetjes së ri-integrimit të viktimave të trafikimit. Palë të reja të Marrëveshjes janë Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe World Vision, kjo e fundit është një organizatë e angazhuar në mbrojtjen dhe parandalimin e shfrytëzimit të fëmijëve.

2. Identifikimi dhe Referimi i Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit

Synimi i aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë, të angazhuar drejtpërdrejtë ose jo në luftën kundër trafikimit të personave, është **rritja e numrit të identifikimeve dhe referimeve të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të shfrytëzuara brenda vendit, në kufi, jashtë vendit dhe vet-identifikimeve.** Identifikimi është procesi më i rëndësishëm në zinxhirin e përpjekjeve për të siguruar mbrojtjen dhe asistencën e viktimave të trafikimit. Tashmë çdo identifikim dhe referim i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit kryhet në përputhje me PSV-të. Burimi fillestar identifikues ka qenë i gjerë: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shërbimi Social Shtetëror, qendrat, Prokuroria e Krimeve të Rënda, OJF, familja. **Zbatimi i PSV-ve është një detyrim ligjor për çdo aktor të përfshirë në identifikimin, referimin, mbrojtjen, asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.** Njësia Antitrafik ka monitoruar në vazhdimësi zbatimin e PSV-ve. Në këtë proces monitorimi ka asistuar dhe Autoriteti Përgjegjës **i cili gjithashtu ka asistuar strukturat e varësisë për identifikimin dhe referimin e rasteve të referuara nga Serbia, Anglia, Italia, Kosova dhe Greqia.**

Për të siguruar një zbatim korrekt të PSV-ve, Njësia Antitrafik dhe IOM kanë zhvilluar **12 trajnime multidisiplinare** me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (antitrafik, kufirit, miturve), Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale Arsimore, Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, Inspektorati Shtetëror i Punës etj. **Në bashkëpunim me OSBE janë zhvilluar trajnime me personelin e Inspektorateve Shtetërore të Punës.** Trajnimet janë zhvilluar gjatë muajve janar-nëntor 2012 me përfaqësues nga 12 qarqet e vendit⁸. Gjithashtu, për të lehtësuar zbatimin e PSV-ve, Njësia Antitrafik në bashkëpunim me IOM kanë hartuar broshura, të cilat përmbajnë informacion të thjeshtëzuar mbi zbatimin e PSV-të për aktorët përgjegjës të këtij procesi: (1) policinë antitrafik, (2) policinë kufitare dhe të

⁷ Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Tjetër Vizion-Elbasan, Të ndryshëm & të barabartë-Tiranë, Vatra-Vlorë, ARSIS-Tiranë, IOM, World Vision.

⁸ Një pasqyrë të plotë mbi trajnimet në fushën e luftës kundër trafikimit të personave do të gjeni në kapitullin Koordinimi.

migracionit, (3) sektorin për të miturit, (4) shërbimet sociale shtetërore, (5) shëndetin publik, (6) agjencitë arsimore, (7) ISHP, dhe (8) zyrat konsullore. Aktualisht janë shpërndarë 4000 kopje të broshurave dhe pritet të shpërndahen edhe kopjet e tjera të riprintuara.

Shtetasi/et shqiptarë shfrytëzohen në të shumtën e rasteve për qëllime seksuale. **Gjatë periudhës së raportimit janë identifikuar dy persona me shtetësi filipinase si viktima të mundshme trafikimi me qëllim shfrytëzimin për punë.** Për këto raste bashkëpunuan Njësia Antitrafik, IOM, Autoriteti Përgjegjës dhe DPPSH për kthim e tyre në vendin e origjinës, vendim i marrë nga vetë përfituesit. **Kjo çështje u regjistrua në muajin janar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda.**

Profili i Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit

Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit të identifikuar vijnë nga familje me formim të ulët arsimor dhe me të ardhura të pakta. Kanë ekzistuar raste ku vajzat për shkak të mosmarrëveshjeve me familjarët e tyre, janë larguar nga shtëpia dhe më pas janë bërë pre e rrjetit të trafikimit me qëllim shfrytëzimin e tyre për prostitucion.

Për sa i përket fëmijëve/viktima të trafikimit shfrytëzimi kryhet kryesisht nga prindërit. Fëmijët, viktima të trafikimit dhe shfrytëzimit janë me prejardhje nga familje tërësisht jo-funksionale. Fëmijët kryesisht janë nga komuniteti rom dhe egjiptianë. Ata shfrytëzohen kryesisht për lypësi dhe janë të ekspozuar ndaj shfrytëzimeve apo abuzimeve të shumëllojshme.

Si vende të shfrytëzimit janë pikat kyçe të qytetit të Tiranës, Durrësit apo qendra të tjera të mëdha urbane të tilla si semaforë, shëtitore kryesore, trotuare në rrugët kryesore etj. Gjatë sezonit turistik veprimtaria zgjerohet në vendet turistike; po ashtu pikat kufitare të kalimit përdoren nga fëmijët dhe mbikëqyrësit e tyre për të ngjallur mëshirë tek emigrantët që kthehen në shtetin amë apo vizitorë të huaj. Kosova mbetet destinacion kryesor për shkak të procedurave më të thjeshta të kalimit të kufirit. Trafikimi i fëmijëve kryesisht romë së bashku me familjarët e tyre drejt Kosovës shtohet në periudhën e verës pasi gjatë kësaj periudhe kthehen emigrantët kosovarë në vendin e origjinës. **Për këtë qëllim Njësia Antitrafik negocioi dhe arriti të nënshkruajë me autoritetet kosovare Protokollin Shtesë “Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe për Përmirësimin e Identifikimit, Njoftimit, Referimit dhe Kthimit Vullnetar të Ndihmuar të Viktimave, si dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, në veçanti të Fëmijëve, në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar”.** **Ky Protokoll u nënshkrua më 12 Qershor, 2013.**

Identifikimi dhe Policia

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka vazhduar të jetë aktive në identifikimin e rasteve të trafikimit, duke zbatuar plotësisht PSV-të, si hallkë e rëndësishme në intervistimin formal dhe identifikimin formal të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Policia e Shtetit ka

bashkëpunuar plotësisht me KKSAT dhe anëtarët e MKR-së për dhënien e shërbimeve të nevojshme për viktimat e trafikimit. Trajnimet kanë vazhduar intensivisht.

Në zbatim të PSV-ve, Njësia Antitrafik ka kërkuar për të gjithë aktorët zbatues të hartojnë dokumente udhëzuese për zbatimin e PSV-ve. Për këtë qëllim **është hartuar Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit⁹** i iniciuar nga Departamenti Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Departamenti për Sigurinë Publike, **me qëllim zbatimin e procedurave standarde të veprimit.**

Si rezultat çdo strukturë policore (Policia Kufitare, Policia Antitrafik dhe Sektori për të Miturit), ka broshurën përkatëse për kryerjen me sa më korrektësi identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

Identifikimi dhe referimi i viktimave/viktima të mundshme të trafikimit është një proces që kërkon një përkujdes të veçantë, një njohje të mirë të psikologjisë së viktimës, dhe një komunikim të kujdesshëm. Për këtë qëllim trajnimet dhe udhëzimet për strukturat policore do të jenë të vazhdueshme dhe specifike. **Autoritetet drejtuese policore i udhëzojnë në vazhdimësi strukturat vartëse për të garantuar në kontakt të parë me viktimën dhënien e sigurisë ndaj viktimës, informimin mbi të drejtat dhe shërbimet e nevojshme. Intervista formale me viktimën synon të jetë sa më informative, e shkurtër dhe sensitive ndaj gjendjes së veçantë në të cilën është viktimia.**

Identifikimi dhe Shërbimi Social Shtetëror dhe Shoqëria Civile

Punonjësit socialë shtetërorë të Zyrave Rajonale të Shërbimit Social kanë marrë pjesë gjatë intervistës formale për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit. **Në bazë të PSV-ve punonjësit e qendrave kanë mundësi të jenë të pranishëm në intervistën formale dhe në bazë marrëveshjeje me zyrat rajonale të ShSSH mund të kryejnë intervistën në vend të punonjësit social të ShSSH.**

Gjatë vitit 2012 u bë e mundur **vendosja e punonjësve socialë pranë pikës të kalimit kufitar Kapshticë. Organizata “ARSIS”, anëtare e MKR-së, një organizatë e specializuar për shërbime ndaj fëmijëve, shprehu vullnetin dhe angazhimin për vendosjen e punonjësve socialë në këtë pikë kufitare.** Bashkëpunimi realizohet me anë të një marrëveshjeje dypalëshe. Nga ky bashkëpunim janë ndaluar në kufi në tentativë për të hyrë në shtetin grek pa dokumentacion: 6 vajza dhe 11 djem (fëmijë)

Në kuadër të projektit “Rritja e përpjekjeve riintegruese për viktimat e trafikimit në Shqipëri” me financim të King Baudouin Foundation, D&E ka asistuar në programin riintegrues të organizatës gjatë periudhës së raportimit, 8 meshkuj viktimat trafikimi/ viktimat të mundshme trafikimi. Nga këta, 2 raste të rritur me shtetësi Filipinase të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë dhe 5 rastet e tjerë (4 të rritur dhe 1 fëmijë) me shtetësi shqiptare janë referuar nga organizata ARSIS. Dy rastet me shtetësi Filipinase kanë bërë intervistën formale dhe kanë marrë statusin

⁹ Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 387, datë 24.08.2012 Për identifikimin dhe referimin e VeT, në bazë të procedurave standarde të veprimit të miratuara me VKM

viktima trafikimi; ndërsa 6 rastet e tjera edhe pse janë shfrytëzuar, kanë kërkuar të mos e bëjnë intervistën formale në ambientet e Policisë duke mbetur në statusin viktime të mundshme trafikimi. Rastet janë asistuar në apartamente me qira dhe 1 rast në familje duke u ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme riintegruese.

Aktualisht D&E është në fazën finale të përfundimit të studimit mbi identifikimin dhe ndihmën ndaj meshkujve të trafikuar në dhe nga Shqipëria.

Identifikimi dhe Drejtoria e Shërbimeve Konsullore, Ministria e Punëve të Jashtme

Një nga angazhimet kryesore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, si anëtare e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, është nxitja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore për shfrytëzimin e të gjitha burimeve të mundshme për identifikimin, mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës ndaj viktimave të trafikimit. Në përmbushje të PSV-ve, **MPJ ka udhëzuar ambasadat dhe konsullatat gjerësisht për institucionalizimin e bashkëpunimit me autoritetet e vendit pritës dhe me organizatat jofitimprurëse.** Nëpërmjet një dokumenti qarkor për gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare, është dërguar një **modelar udhëzues** se si duhet të veprojnë diplomatët për zbatimin e PSV-ve dhe Planit të Veprimit 2011-2013, janë udhëzuar se si duhet të veprojnë ata në rastet kur një shtetas shqiptar jashtë vendit gjendet në një situatë trafikimi. Përfaqësitë janë porositur që këtë udhëzim ta afishojnë në një vend të dukshëm dhe ta hedhin edhe në faqen elektronike të tyre.

Identifikimi dhe Inspektorati i Punës

Gjatë periudhës së raportimit Inspektorati i Punës ka intensifikuar përpjekjet për ndërgjegjësimin e strukturave të varësisë lidhur me identifikimin fillestar të shfrytëzimit për punë. Njësia Antitrafik ka iniciuar një projekt të mbështetur financiarisht nga OSBE, lidhur me promovimin e një përqsajeje proaktive ndërinstucionale në luftë kundër shfrytëzimit për punë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve, ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të aktorëve shtetërorë, që mund të kryejnë identifikimin e rasteve të shfrytëzimit për punë dhe rritjes së bashkëpunimit me sektorin privat. Ky proces është iniciuar në muajin janar 2012, kohë kur Njësia Antitrafik dhe OSBE kanë ndërmarrë takime me aktorë të ndryshëm të përfshirë në këtë proces. Faza e parë e këtij projekti kishte për qëllim identifikimin e mekanizmave të mundshëm të bashkëpunimit për të identifikuar, referuar, ndjekur rastet e shfrytëzimit për punë dhe rritjen e kapaciteteve për këtë qëllim. **Adresimi i fenomenit të shfrytëzimit për punë është një nga prioritetet kryesore të parandalimit të fenomenit të trafikimit të personave në Shqipëri.**

Për këtë qëllim, Njësia Antitrafik dhe OSBE zhvilluan katër seminare multidisiplinare me përfshirjen e aktorëve nga agjenci të ndryshme: Inspektorati i Punës/Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror/Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Sportelet e Migracionit/Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Zyrat e Punësimit/Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Sektori i Luftës kundër Trafiqeve të Paligjshme/Policia e Shtetit, Sektorët e Migracionit dhe Ripranimeve/Policia e Shtetit, Sektori i Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje/Policia e Shtetit, Kryetarët e Tryezave Teknike të Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

3. Mbrojtja e Viktimave të Trafikimit Dëshmitare

Për këtë periudhë po zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes për një viktimë trafikimi (femër), për shkak të bashkëpunimit të saj me Prokurorinë për Krime të Rënda, Tiranë për veprën penale “Trafikim i femrave” parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal. Në zbatim të nenit 28 të ligjit nr.10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar, është hartuar *Projektudhëzimi i Përbashkët të Ministrisë të Brendshme, Ministrisë të Drejtësisë dhe Prokurorisë të Përgjithshme “Për kushtet, rregullat, procedurat dhe mënyrat e zbatimit të programit të mbrojtjes, ndaj bashkëpunëtorëve të drejtësisë, kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për programin e mbrojtjes”*. Masat e posaçme të mbrojtjes që zbatohen janë: ndryshim vendbanimi, mbrojtje fizike dhe teknike në vendin ku qëndron personi dhe gjatë lëvizjes, dhënia e dokumenteve, dhënia e ndihmës financiare, rehabilitim social, rikualifikim profesional.

4. Mbështetje e viktimave të trafikimit dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik në mbrojtjen dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka nën varësi institucione në nivel qendror dhe lokal të cilat kanë detyra të ndryshme funksionale në luftën kundër trafikimit të personave. Institucionet të cilat kanë detyrime të drejtpërdrejta në mbështetjen, ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social dhe riintegrimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të mundshme të Trafikimit janë:

- **Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale:** harton dhe propozon politika për mbështetjen e individëve, familjeve, grupeve dhe komuniteteve në nevojë me pagesa në lek dhe shërbime shoqërore në nivel komunitar, me qëllim parandalimin e diskriminimit dhe përjashtimit social, duke nxitur rehabilitimin, integrimin dhe përfshirjen e tyre në jetën shoqërore. Monitoron zbatimin e politikave në këto fusha.
- **Shërbimi Social Shtetëror:** ndjek zbatimin e politikave dhe të legjisllacionit në fushën e shërbimeve sociale. Janë 12 struktura rajonale në 12 qarqe. Në zbatim të VKM Nr. 582, datë 27.07.2011 “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, punonjësit social të ZRSHSSH janë të përfshirë në procesin e identifikimit dhe referimit. Gjithashtu këto struktura monitorojnë subjektet publike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për Viktimat e Trafikimit.
- **Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqëror:** inspekton subjektet publike dhe jo-publike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për Viktimat e Trafikimit ose Viktimat e Mundshme të Trafikimit.
- **Drejtoria e Politikave të Punësimit:** harton dhe miraton programet aktive dhe pasive të punësimit në vend, përfshi edhe caktimin e kategorive që përfitojnë nga këto programe (si p.sh. viktimat e trafikimit);
- **Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP):** zbaton politikat e punësimit të vendosura nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për viktimat e trafikimit viktimat e mundshme të trafikimit në tregun e punës. SHKP operon

nëpërmjet zyrave të punësimit rajonale dhe vendore. Në drejtorinë e përgjithshme të SHKP dhe në zyrat rajonale të punësimit janë ngritur struktura të posaçme për ofrimin e shërbimit të këshillimit për karrierën, hyrjen në punë, dhe formimit profesional për Viktimat /Viktimat e Mundshme të Trafikimit. Kjo strukturë në bashkëpunim me institucione të tjera janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta të punësimit me bizneset private të VeT/Viktimat e Mundshme të trafikimit.

Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror administron Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, qendër e sigurisë së lartë. **Buxheti i akorduar nga buxheti i shtetit, Fondi i Mbrojtjes Sociale për ofrimin e shërbimeve shoqërore për Viktimat e Trafikimit dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit është në vlerën 29.5 milion lekë për vitin 2012 për Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit.** QKPVT ka si qëllim ofrimin e ndihmës, rehabilitimit dhe riintegrimin të viktimave të trafikimit, vendase dhe të huaja. Në QKPVT përfitueseve menjëherë pas akomodimit në qendër, iu ofrohen shërbimet imediate si: ushqim, veshje, strehim etj.

Financim nga buxheti i shtetit për qendrat pritëse jopublike¹⁰. Në zbatim të Nenit 4, të Ligjit nr. 10252, datë 11.03.2010 “Për disa ndryshime në Ligjin 9355, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 10355, datë 02.12.2010 “Për Buxhetin e Vitit 2012”, për Vitin 2012, **Ministria e Punës transferon fonde (ushqimi) në Programin e “Mbrojtjes Sociale” për përfituesit Viktima Trafikimi, që marrin shërbime shoqërore në ofruesit e shërbimeve jo-publike.** Për periudhën kohore Janar – Dhjetor 2012 është dhënë asistencë sociale për: Shoqatën “**Tjetër Vizion**” Elbasan **fondi prej 203.840 lekë për 4 viktima trafikimi** duke iu referuar kërkesës së bërë nga Bashkia Elbasan. Ndërsa për Shoqatën “**Të ndryshëm dhe të barabartë**” **fondi i alokuar është 560.560 lekë për 11 viktima trafikimi sipas kërkesës së Njësisë bashkiake Nr. 7 Tiranë.**

Me përmirësimin e kuadrit ligjor për licencimin e OJF-ve si ofrues të shërbimeve shoqërore janë lehtësuar procedurat e ofruesve të shërbimeve që kërkojnë të marrin licencën, është rritur transparenca ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve shtetërore. Ky legjislacion i ndryshuar solli krijimin e **Qendrës Kombëtare të Licencimit si institucion i drejtpërdrejt i dhënies së licencës.** Vlen për t’u theksuar se tashmë rrjeti i OJF –ve të cilët ofrojnë shërbime sociale rezidenciale për viktimat e trafikimit, është konsoliduar në vazhdimësi, dhe ka qëndrueshmëri në veprimtarinë specifike të tyre, falë edhe sistemit të monitorimit dhe inspektimit të standardeve të shërbimeve shoqërore nga ana e Inspektoratit të Shërbimeve Sociale.

“**Vatra**” bazuar në zbatimin e PSV-ve dhe MKR-në e rishikuar, ka realizuar rinovimin e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me 6 institucione dhe konkretisht : Drejtorinë e Policisë Qarku Vlorë, Drejtorinë e Policisë Qarku Fier, Komuna Novoselë, Bashkia Selenicë, Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit, Avokati i Popullit, Policia e qarkut Berat dhe Vlorë. “Vatra” është në proces të nënshkrimit të marrëveshjeve edhe me aktorë të tjerë lokalë, përgjegjës të zbatimit të MKR-së, PSV-ve dhe Planit të Veprimit 2011- 2013. “Vatra” ka

¹⁰ “Vatra” nuk arriti ta marrë këtë fond në muajin qershor kohën kur ky fond u alokuar për dy qendrat e lartpërmendura.

sjellë në vëmendjen e Njësisë Antitrafik një model pozitiv të bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, anëtarë të MKR-së. Rasti i një vajzë minorene e trafikuar jashtë vendit, u referua tek “Vatra” për ndërmjetësim me autoritete shqiptare për riatdhesimin e saj, si dhe për t’u asistuar më pas nga po kjo qendër. Autoriteti Përgjegjës koordinoi të gjitha veprimet për realizimin e këtij procesi, gjatë të cilit “Vatra” luajti një rol aktiv. Pas kthimit në vend, vajza u trajtua për një periudhë prej më shumë se 3 muaj në QKPVT. Më pas me kthimin në familje, kjo qendër referoi tek “Vatra” trajtimin e rastit në familje për vazhdimësinë e programit të riintegritimit. Me mbështetje të ShSSH, të qarkut përkatës, stafi i Vatrës, pas vlerësimit të nevojave dhe situatës sociale dhe ekonomike të familjes së saj, hartoi planin e ndihmës. Përfituesja aktualisht është duke përfutur ndihmën ekonomike në bazë të VKM nr. 796, dt 8.9.2010 dhe në muajin shtator do të rifillojë shkollën si dhe një kurs profesional. Po kështu, familja e saj do të përfitojë një mikrobiznes, me qëllim përmirësimin e situatës ekonomike të saj dhe, si rezultat edhe të përfitueses. Kursi profesional dhe mikrobiznesi do të mbështeten financiarisht nga King Baudouin Foundation dhe Organizaata World Vision, Shqipëri.

“**ARSIS**” thekson se ka marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me disa nga strehëzat antitrafik. Në dy raste sistemimi emergjent fëmijësh viktime të trafikimit të brendshëm, ARSIS ka gjetur gatishmëri për bashkëpunim të ngushtë nga Shtëpia e fëmijës në Sarandë dhe Shkodër. ARSIS ka siguruar nga donatorët fonde për programet e veta përfshirë ato të anti-trafikimit ndaj qenieve njerëzore për të paktën deri në fund të vitit 2013.

5. Shërbimet e ofruara nga Koalicioni i Strehëzave Antitrafik

Agjensitë shqiptare shtetërore dhe jo-shtetërore kanë krijuar mundësinë për t’u ofruar viktimave shërbime të specializuara dhe cilësore. Në Shqipëri, shërbime përfitojnë viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Në të gjitha qendrat pas akomodimit të përfitueseve dhe përmbushjes së nevojave imediate, brenda një afati të përcaktuar nga ekipi multidisiplinar realizohet një vlerësim i nevojave psiko-sociale, shëndetësore, ligjore dhe arsimore. Në vazhdimësi, punonjësi social harton planin e ndihmës, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë në qendër, në varësi të nevojave të përfitueses. Ky plan miratohet nga përfituesja/përfituesi dhe zbatohet gjatë periudhës së akomodimit në qendër. Qendrat janë të specializuara për të dhënë ndihmë në të tria fazat e ndihmës: asistencë fillestare, asistencë afatmesme, asistencë afatgjatë.

Asistenca psiko-sociale/Këshillime:

Qendrat ofrojnë për viktimat e trafikimit këshillime dhe sesione informuese në grup ose këshillime individuale, sesione të terapisë dhe terapi okupacionale. Këto realizohen nga stafi i qendrave dhe mbështetje nga jashtë qendrës.

Asistenca ligjore:

Avokatët e qendrave ofrojnë këshillim dhe asistencë ligjore për të gjitha rastet e paraqitura në qendër dhe që kanë kërkuar këtë shërbim. Gjatë seancave të parë të këshillimit, përfitueset janë informuar rreth legjislacionit shqiptar në mbrojtje të tyre. **Në total kanë marrë këtë shërbim në qendrën “Vatra”, 9 viktime / viktime të mundshme trafikimi.**

Gjatë kësaj periudhe **Tjetër Vizion** në bashkëpunim me institucionet e zbatimit të ligjit dhe Qendrën Avokatore falas të ofruara nga një prej organizata të grave në Elbasan **ka mbështetur, shoqëruar dhe ofruar asistencë ligjore për 4 përfituese.**

D&E ka bashkëpunuar me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare në bazë të një marrëveshjeje mes të dy institucioneve për të ofruar ndihmë ligjore për rastet e reja të hyra në program. **Gjatë kësaj kohe 10 raste të reja janë duke u ndjekur nga Prokurorët pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda apo Prokurorive të Rretheve ku ato kanë bërë denoncimin.** D&E ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Njësinë Bashkiake nr. 10 për pajisjen me dokument identifikimi të përfitueseve të programit.

ARSIS ofron asistencë administrative të tillë si përftim/plotësim dokumentacioni për një mori çështjesh për përfituesit viktime të trafikimit.

QKPVT, në zbatim të standardeve të miratuara në stafin e Qendrës është punësuar një juriste pjesë e ekipit multidisiplinar, e cila ndjek proceset gjyqësore të përfitueseve në bashkëpunim me prokurorët e çështjeve, po ashtu dhe me përfaqësues të fushës antitrafik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Pjesë e mirëfeksionimit të QKPVT-së është edhe asistenca dhe mbështetja e viktimave të trafikimit nga Institucionet Ligjore. Kështu gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2012 për Viktimat e Trafikimit në nivel të lartë rrezikshmërie për jetën, për të cilat shkalla e sigurisë dhe domosdoshmëria e përfshirjes së tyre në programin e mbrojtjes së dëshmitarit paraqitet e lartë, puna është koordinuar nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellët me organet e pushtetit gjyqësor.

Gjykatat nuk mundësojnë asnjë lloj lehtësimi apo reduktimi të pagesave në gjykatë, qoftë kjo dhe për psikologun e gjykatës, të cilën qendrat apo palët kanë qenë të detyruar ta paguajnë vetë.

Asistenca mjekësore:

Ministria e Shëndetësisë është anëtare e re në MKR dhe ka detyrime specifike për sigurimin e ofrimit të kujdesit shëndetësor V/VMT dhe bashkërendimin e këtij kujdesi në funksion të nevojave komplekse të këtyre personave. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim dhe IOM, kanë organizuar një seri trajnimesh dy ditore në të 12 qarqet e vendit, me përfaqësues nga të gjitha strukturat e përfshira në çështjet e trafikimit dhe zbatimit të PSV-ve. Trajnimet u shtrinë në periudhën kohore shkurt-maj 2012 dhe synimi kryesor i tyre ishte informimi i punonjësve të sektorit të shëndetësisë (ndër sektorë apo organizma të tjera pjesëmarrëse) mbi detyrimet e zbatimit të procedurave për identifikimin dhe referimin të V/VMT, kjo edhe nëpërmjet prezantimit të broshurave për sektorin shëndetësor. Gjithashtu kjo pjesëmarrje multidisiplinare bëri të mundur ngritjen e urave të bashkëpunimit ndër sektorial dhe ndarjen e kompetencave, detyrimeve dhe pozicioneve të secilit aktor në zinxhirin e sistemit të mbrojtjes dhe asistencës për V/VMT. Ministria e Shëndetësisë ka marrë pjesë në formë aktive në të gjitha trajnimet me problematikën e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. **Nga sektori shëndetësor janë trajnuar rreth 50 profesionistë duke përfshirë dhe pikat fokale antitrafik në Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe.** Ministria e Shëndetësisë me mbështetjen e Njësisë Antitrafik dhe IOM, ka hartuar, publikuar dhe shpërndarë Udhëzuesin për Zbatimin e

Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit (PSV), "Punonjësit e shëndetësisë për viktimat e trafikimit dhe Viktimat e mundshme të trafikimit". Ky dokument synon të ndihmojë ofruesit e kujdesit shëndetësor, kryesisht të parësorit, për shfrytëzimin e mundësive që japin PSV-të duke përdorur aftësitë dhe eksperiencën e tyre në funksion të sigurimit të asistencës së nevojshme shëndetësore të V/VMT. **Spektori shëndetësor nuk ka pasur raste të identifikimit fillestar dhe referimit të viktimave të mundshme të trafikimit, nga miratimi i PSV-ve dhe deri më tani.**

Në fund të vitit 2011 u ngrit një grup pune për hartimin e projekt – Vendimit të Këshillit të Ministrave "*Për Trajtimin e Viktimave të Trafikimit dhe Përfitim të Shërbimeve Shëndetësore nga kjo Kategori*", ky dokument ligjor u miratua nga Këshilli i Ministrave në datën **20.06.2012**, me VKM Nr. 395, duke i dhënë zgjidhje ligjore një problemi të ndjeshëm siç është ai i shërbimit shëndetësor me përfshirjen e kësaj kategorie në kategorinë e personave ekonomikisht joaktiv, ku kontributi në fondin e sigurimeve shëndetësore për këta persona paguhet nga shteti.

Qendrat kanë bërë të mundur lehtësimin e dhënies së shërbimeve shëndetësore për të gjithë viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit të trajtuara në këto qendra. Problemet e shëndetit ndiqen nga afër në qendra nga stafi mjekësor i qendrës: shtatzëni, vaksinim të fëmijëve që lindin, shërbime dentare, shërbime të përfituesve me probleme të shëndetit mendor, ekzaminime dhe analiza.

Arsimimi:

Pas një vlerësimi të bërë për përcaktimin e nivelit arsimor të çdo përfitueseje, zhvillohet një plan edukativo-mësimor si pjesë e planit të riintegritimit individual. **Qendrat, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale arsimore kanë bërë të mundur regjistrimin dhe vazhdimin e shkollës për disa përfituese.** Mësuesit e qendrave zhvillojnë orë ditore mësimore në qendra me përfitueset. **D&E raporton se 21 përfituese kanë ndjekur gjatë kësaj periudhe shkollën, 7 përfituese janë regjistruar në sistemin arsimor për herë të parë këtë vit shkollor. ARSIS në lidhje me përkrahjen për arsimim ofron: klasa plotësuese për fëmijët që ndjekin arsimin e detyruar, klasa të veçanta jo-formale për fëmijët që kanë braktisur shkollën dhe klasa analfabetizmi për fëmijët që nuk dinë shkrim e këndim. Vatra raporton se 5 viktima/viktima të mundshme të trafikimit janë regjistruar dhe vazhdojnë mësimin rregullisht. Tjetër Vizion raporton se 1 përfituese 19-vjeç (VMT), ka përfunduar me sukses klasën e shtatë dhe ka filluar klasën e tetë.**

Kualifikime profesionale:

Qendrat kanë bashkëpunuar me Drejtoritë e Formimit Profesional për regjistrimin dhe ndjekjen e kurseve nga ana e përfituesve që kanë kërkuar këtë shërbim pranë tyre. Të gjitha përfitueset janë informuar me mundësinë e ndjekjes së një kursi profesional, i cili u jep avantazhe për punësim. Kurset profesionale që ofrohen janë parukeri, rrobaqepësi, kuzhinë, kompjuter dhe gjuhë të huaja. Programi i formimit profesional është gjithashtu një program i mbështetur nga buxheti i

shtetit dhe ofron formim profesional në kurse të ndryshme profesionale, të kërkuara në tregun e punës dhe realizohet pranë 10 qendrave të formimit profesional publik, që janë në qytetet kryesore të vendit. Për periudhën Janar – Dhjetor 2012, pranë Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik, në shkallë vendi, janë regjistruar pranë zyrave të punësimit, për të ndjekur kurset e ofruara **26 punëkërkuese të papuna viktime trafikimi**, që janë certifikuar në profesionet rrobaqepësi, sekretari, kuzhinë dhe parukeri.

Në Urdhrin Nr. 782, datë 04.04.2006 "Për tarifën e sistemit të formimit profesional", i ndryshuar, është parashikuar se tarifën e regjistrimit për punëkërkuetit e papunë të regjistruar në zyrat e punësimit dhe që duan të ndjekin kurse të profesioneve të formimit profesional, të ofruara nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik (DRFPP) janë falas për grupet e veçanta, ku përfshihen edhe punëkërkuetit nga kategoria "Femra të trafikuar". Përfshirja në programet aktive varet edhe nga dëshira e viktimeve.

Punësimi:

"Vatra" gjatë këtij 6-mujori, ndërmjetësoi për punësimin e 19 përfitueseve¹¹, dhe 6 të tjera të vetëpunësuara. "Tjetër Vizion" në bashkëpunim me biznesin lokal ka bërë të mundur punësimin e 4 përfitueseve. Nëpërmjet modelit të ndërmarrjes sociale, ka bërë të mundur punësimin e një viktime të mundshme të trafikimit në parukerinë e hapur prej organizatës dhe 2 të tjera janë vetëpunësuar në minibiznesin e tyre. "Të ndryshëm dhe të barabartë" gjatë periudhës së raportimit ka punësuar 26 raste në vende të ndryshme pune si: kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, pjatatarëse në restorant, pastruese, ndihmëse parukiere në sallon parukerie, shitëse, operatore në "call center", në rrobaqepësi etj. Pesë përfituese të tjera kanë punuar me kohë të pjesshme në biznesin social të "D&E Bagels".

Ndihma ekonomike:

Programi i Ndihmës Ekonomike, mbështet me pagesë mujore familjet pa të ardhura apo me të ardhura të kufizuara. Ndryshimet ligjore të bëra në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" në vitin 2010 tashmë nga programi i ndihmës ekonomike përfitojnë edhe viktimat e trafikimit pas daljes nga qendrat rezidenciale deri në momentin e punësimit të tyre. **Për periudhën Janar-Dhjetor 2012 numri i viktimeve të trafikimit që kanë përfituar ndihmë ekonomike është 16 me një fond prej 288 mijë lekë.**

Ngritja dhe monitorimi i mikrobizneseve:

Qendrat punojnë në mënyrë të vazhdueshme me organizata ndërkombëtare me qëllim ngritjen e fondeve për të mundësuar përdorimin e tyre për hapjen e mikrobizneseve. "Tjetër Vizion" gjatë periudhës së raportimit ka ofruar 4 grante punësimi (3 VMT dhe 1 VT). Gjithashtu, janë në proces ri- integrimi 5 raste (2 VT dhe 3 VMT) të mbështetura financiarisht nga projekti i IOM- USAID dhe 2 VMT të mbështetura nga projekti Swisscontact. Po në këtë periudhë

¹¹ Në këtë grup përfituesesh futen: rastet e reja për vitin 2012, raste të përfshira në monitorimin afatgjatë me nevojën për punësim.

“Vatra” ka vlerësuar edhe 20 raste të përfshira në monitorimin afatgjatë për përfitimin e 5 mikrobizneseve të mbështetura nga IOM Tiranë. Pas një vlerësimi të kujdesshëm të realizuar nga stafi i Vatrës u përcaktuan 5 përfituese për t’u mbështetur me mikrobiznes. D&E ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe të monitorojë përfitueset që kanë hapur bizneset e tyre në vitet e mëparshme. Kështu, momentalisht, **9 përfituese të D&E menaxhojnë bizneset e tyre**. Sipas vlerësimeve të qendrave përfitueset që menaxhojnë mikrobizneset kanë patur ecuri të mirë, ku një prej nxitësve pozitiv ka qenë mbështetja e familjes.

Asistencë për fëmijët e përfitueseve

Qendrat ofrojnë një shërbim mjaft të rëndësishëm, kujdesin për fëmijët e nënave, viktimat trafikimi. Qendrat në bashkëpunim me autoritetet lokale bëjnë të mundur regjistrimin në çerdhe apo shkollë, psikologët dhe mësuesit e qendrës ndjekin nga afër ecurinë e fëmijëve në shkollë dhe shoqëri. “Vatra” ka asistuar 11 fëmijë të përfitueseve si raste të reja për këtë gjashtëmujor dhe 4 fëmijë të përfitueseve të asistuar më parë në strehëz dhe të përfshira në procesin e monitorimit afatgjatë. Kjo asistencë ka konsistuar në mundësimin e shërbimit shëndetësor, regjistrim në çerdhe dhe kopësht, mbështetje me mjetet bazike për jetesë, etj. **Gjatë kësaj periudhe janë asistuar në programin e D&E 28 fëmijë të VT** të shoqëruara me nënat e tyre nga ku 6 fëmijë janë ndihmuar në Qendrën e Riintegritimit dhe 22 janë asistuar bashkë me nënat në fazën e dytë të programit. 3 fëmijë kanë frekuentuar çerdhen, 2 fëmijë kanë frekuentuar kopshtin, ndërsa 9 fëmijë të tjerë kanë ndjekur shkollën. D&E ka lehtësuar procesin e regjistrimit të dy fëmijëve të një përfitueseje në një nga shkollat e Tiranës.

Ndërmjetësim me familjen:

Një nga sfidat e punës së qendrave është edhe vendosja e kontakteve me familjet e viktimave të trafikimit dhe kthimi i tyre pranë familjarëve. Qendrat ndihmojnë në ndërmjetësimin e marrëdhënieve të viktimës me familjen (kjo në ato raste kur familja nuk ka qenë pjesë e rekrutimit të tyre). Ky shërbim është ofruar si përmes vizitave në familje ashtu edhe takimeve të ndryshme të realizuara në zyrat e Qendrave. Këshillimet në familje janë realizuar nga stafi social dhe psikologu i qendrës pas vlerësimit të nevojave në këtë drejtim dhe janë trajtuar sipas problematikave specifike të hasura. Duke qenë se familja luan rolin kyç në ecurinë e përfituesve, paralelisht me mbështetjen psiko-sociale të rasteve, u është ofruar asistencë dhe këshillim prindërve apo edhe familjarëve të tjerë sipas problematikave të shfaqura.

“Vatra” ka realizuar në total **51 këshillime me familjarët**¹² në familje dhe në zyrat e qendrës. Për 6 raste të reja këtë periudhë janë trajtuar me këshillime dhe terapi të gjithë anëtarët e familjes. “Tjetër Vizion” ka bërë të mundur riintegritimin në familjen e origjinës të 2 rasteve VeT dhe 1 VMT. D &E ka bërë të mundur bashkimin e 9 përfitueseve me familjet e tyre.

¹² Këtu futen edhe 11 këshillime të realizuara në kuadër të monitorimit afatgjatë.

Aktivitetet sociale jashtë qendrës:

Qendrat raportojnë se aktivitetet me natyrë argëtuese dhe relaksuese zhvillohen në mënyrë të shpeshtë. Zhvillimi i këtyre aktiviteteve është domosdoshmëri për shëndetin fizik dhe mendor të përfitueseve. Konkretisht zhvillohen ekskursione, vajtje në plazh, festime ditëlindjesh të përfitueseve, festimin e festave kombëtare, vajtje në kinema, teatër, shëtitje në natyrë, çuarja e fëmijëve në këndin e lojërave etj.

Monitorimi dhe ndjekja e rasteve:

Pas ofrimit të gjithë këtyre shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese hapi i tretë është edhe më i rëndësishmi, ndjekja dhe monitorimi i rasteve gjatë procesit afatgjatë të riintegrit. Format e monitorimit dhe ndjekjes së rasteve janë vizitat që punonjëset sociale bëjnë në familjet e viktimave, në vendet ku ato jetojnë, në bisedat me to, në bisedat me të afërmit e tyre. Strehëzat raportojnë se procesi i monitorimit është fokusuar kryesisht mbi shëndetin e përfitueseve, situatën e punësimit, kërkesat për rritje profesionale nëpërmjet kurseve më të avancuara, ecuria e marrëdhënieve me familjen, marrëdhëniet ndërpersonale, asistenca ligjore, nevojat për këshillim psiko – social, probleme sigurie, menaxhimi i aktiviteteve ditore dhe të ardhurave. Përqindja e regresit është e vogël por qendrat kanë evidentuar disa faktorë kryesorë regresi:

- 1- Të ardhurat e pamjaftueshme për të mbuluar kostot e një jetese normale;
- 2- Papunësia dhe gjendja ekonomike e varfër në familje;
- 3- Probleme me familjarët, të afërmit dhe komunitetin ku jetojnë.

Gjatë këtij viti D&E u mbështet për të hapur një qendër komunitare për aktivitete edukative, trajnime dhe aktivitete sociale për rastet që asistohen në programin e riintegrit. **Qëllimi i projektit është të sigurojë mjetet për një riintegrim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të viktimave shqiptare të trafikimit nëpërmjet trajnimeve për rritjen aftësive dhe aktiviteteve edukative. Donator i projektit është IBVM (Loreto). Qendra e edukimit u hap në Korrik të vitit 2012. Në këtë qendër ndodhen:**

- një ambient i veçantë për organizimin e terapisë së artit, terapisë okupacionale dhe kurseve të muzikës;
- një ambient i veçantë i pajisur me kompjuter shërben për organizimin e kurseve të kompjuterit;
- një ambient tjetër përfshin Bibliotekën dhe sallën e trajnimeve ku zhvillohen aktivitete të ndryshme;
- një ambient i qetë dhe i veçantë është krijuar për zhvillimin e seancave psikologjike individuale dhe në grup.

6. Rekomandime

- Të forcohet bashkëpunimi dhe besimi i AMKR;

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

- Të zbatohen në mënyrë proaktive procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
- Të rritet financimi për qendrat që ofrojnë shërbime për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit;
- Të vazhdojnë trajnimet që sigurojnë informacion mbi praktikat më të mira për identifikimin e viktimave të trafikimit;
- Të vijojnë të kryen intervistat formale pavarësisht dhënies më parë të dakordësisë nga viktima për dhënien e kallëzimit;
- Të hartohen programe të veçanta punësimi për viktimat e trafikimit;
- Të shtohet numri i viktimave të trafikimit që punësohen me ndërmjetësimin e zyrave të punës;
- Të vazhdojë të përforcohet bashkëpunimi midis strukturave të Policisë së Shtetit, SHSSH dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafikim;
- Të vazhdojë trajnimi i punonjësve konsullorë në ambasada dhe konsullata për t'u aftësuar për evidentimin e personave që mund të jenë në rrezik trafikimi;
- Të vazhdojë të forcohet roli i prokurorëve special për çështjet e trafikimit në njerëz dhe roli advokues i koordinorit për viktimat;
- Të lehtësohen pagesat në gjykatë.

III. PARANDALIMI

Parandalimi i trafikimit të personave është një nga katër shtyllat bazë mbi të cilat ngrihen të gjitha masat dhe politikat antitrafikim në Shqipëri. Në thelb të tij, ai kërkon të kuptohet fenomeni i trafikimit që në rrënjë dhe të gjenden mënyra për të minimizuar faktorët e rrezikut. Veprimtaria parandaluese fokusohet kryesisht në ndërgjegjësimin e publikut mbi fenomenin e trafikimit dhe gjithçka që lidhet me të, arsimimin, rritjen e përfshirjes sociale të grupeve në nevojë, ofrimin e alternativave të tjera ndaj trafikimit, iniciativat për zhvillim shoqëror dhe ekonomik si dhe uljen e varfërisë.

1. Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor

Në 15 qershor 2012 u nënshkrua Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit pas rishikimit të Marrëveshjes ekzistuese miratuar në 2005. Qëllimi i rishikimit të kësaj Marrëveshjeje ka qenë qartësimi i roleve dhe përgjegjësi të të gjithë aktorëve të përfshirë në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimat/viktimave të mundshme të trafikimit në përputhje edhe me Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit. Gjithashtu, është shtuar numri i firmëtarëve të kësaj Marrëveshjeje, me aktorë si shtetërorë dhe jo shtetërorë, duke ofruar një ndihmë më gjithëpërfshirëse për viktimat dhe duke ushqyer partnershipin tashmë të konsoliduar të qeverisë shqiptare me shoqërinë civile në drejtim të luftës kundër trafikimit të personave.

Në datat 11-12 qershor 2012 u nënshkrua në Kosovë nga Pala Shqiptare dhe Pala Kosovare Protokollin “Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe për Përmirësimin e Identifikimit, Njoftimit, Referimit dhe Kthimit Vullnetar të Ndihmuar të Viktimave, si dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, në veçanti të Fëmijëve, në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar”. Ky Protokoll merr rëndësi jo vetëm për faktin se do të përmirësojë bashkëpunimin mes dy palëve në luftën kundër trafikimit të personave, por edhe sepse një fokus të veçantë në të marrin fëmijët, të cilët kanë të drejtë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm.

Shërbimi Social Shtetëror, në zbatim të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2007-2013, dhe në bashkëpunim me disa institucione, ka hartuar Planin e Veprimit për Reformimin e Shërbimeve Sociale në nivel lokal. Qëllimi i këtij Plani është vazhdimi i reformimit të shërbimeve sociale në kuadër të avancimit të procesit të decentralizimit dhe deinstitutionalizimit të tyre, si dhe modelimi i shërbimeve sociale sipas një perspektive gjithëpërfshirëse dhe të integruar. Në këtë Plan jepen veprime konkrete për rregulloret, politikat, procedurat, kapacitetet, sistemet dhe shërbimet sociale që synojnë të mbrojnë individët dhe grupet në nevojë, si dhe afate konkrete për të gjitha veprimet që duhen ndërmarrë në nivel qendror dhe lokal, duke i shërbyer harmonizimit në planifikimin dhe monitorimin e tyre.

2. Ndërgjegjësimi publik

Ndërgjegjësimi publik është një nga masat kryesore të politikës parandaluese të trafikimit të personave që ndjek Qeveria Shqiptare. Fushatat ndërgjegjësuere shërbejnë për ta njohur publikun me fenomenin e trafikimit të personave, rreziqeve dhe pasojave që ai mbart.

Njësia Antitrafik ka vazhduar fushatën e gjerë mbarëkombëtare kundër shfrytëzimit që u bëhet fëmijëve për punë dhe lypje të detyruar me moton “**Fëmijëria nuk është shfrytëzim për punë**”, e cila është shtrirë gjatë gjithë vitit 2011 e në vazhdim të vitit 2012, në bashkëpunim të ngushtë me koalicionin “Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve” (BKTF) dhe World Vision. Gjatë muajit qershor kjo fushatë ka marrë formën e konferencës për shtyp në Tiranë, të mbajtur nga vetë fëmijët, gjatë së cilës janë dhënë mesazhe kundër shfrytëzimit të fëmijëve për punë. Pjesë e kësaj fushate ka qenë edhe spoti i shkurtër publicitar kundër trafikimit të personave, realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme në vitin 2011, i cili është transmetuar në çdo qytet ku janë mbajtur aktivitetet ndërgjegjësuere.

Në datën 18 Tetor 2012, Dita Evropiane Antitrafikim, Njësia Antitrafik ka organizuar konferencën “Të gjithë bashkë kundër trafikimit të personave! Respekt për të drejtat e viktimës-Jepini fund Stigmës”, në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafikim, Prefekturën e Tiranës, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe IOM. Kjo konferencë u mbajt në një nga auditorët e Universitetit të Tiranës me pjesëmarrjen e përfaqësuesve shtetërorë, OJF-ve dhe studentë të Fakultetit Juridik. Siç është bërë traditë tashmë, qëllimi i këtij aktiviteti është të rritet ndërgjegjësimi dhe të dërgohen mesazhe kundër trafikimit të personave.

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) vazhdon të ndërgjegjësojë të gjithë personelin e përfaqësive tona diplomatike nëpërmjet udhëzuesve dhe materialeve informuese për procedurat që duhet të ndjekë ky personel gjatë kontaktit me viktimën apo viktimën të mundshme trafikimi. Në këtë plan, MPJ vazhdon të publikojë materialin udhëzues “*Kur një shtetas shqiptar jashtë vendit gjendet në një situatë trafikimi*” në faqen e saj të internetit, i cili u vjen në ndihmë si përfaqësive tona diplomatike, ashtu edhe vetë shtetasve shqiptarë të trafikuar apo në rrezik trafikimi (http://www.mfa.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=7361%3Ambrojtja-dhe-asistenca-konsullore-ndaj-shtetasve-shqiptare&catid=96%3Asherbime-konsullore&Itemid=79&lang=sq).

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh ndërgjegjësuere dhe trajnimesh të stafit shkollor. Për të forcuar rolin e shkollës në mbrojtje dhe ndihmë ndaj fëmijëve, rreth **108 psikologë dhe drejtorë shkollash** janë trajnuar në çështje të lidhura me abuzimin psikologjik të fëmijëve, si identifikohet dhe trajtohet ai, menaxhimi i ankthit dhe stresit në adoleshencë, identifikimi dhe trajtimi i tij etj. **127 drejtorë shkollash** nga 5 Drejtoritë Rajonale të Arsimit në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë dhe Fier kanë qenë pjesëmarrës në trajnimin me temë “Respekt për të drejtat e fëmijëve: disa këshilla që duhen konsideruar gjatë vëzhgimit të mësuesit dhe nxënësit në klasë”. Gjithashtu, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me organizatën Terre des Hommes, ka punuar për përpilimin e një moduli trajnimi “Mbrojtja e fëmijës në shkollë”, i cili, pasi të përfundojë, pritet të akreditohet nga Instituti i Zhvillimit Arsimor.

Psikologët e shkollave, në bashkëpunim me qeveritë e nxënësve, stafin mësimor dhe aktorë të tjerë lokalë si Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës etj., gjatë periudhës së raportimit, kanë organizuar në rang vendi **226 aktivitete ndërgjegjësuese** me nxënësit, mësuesit dhe prindërit për tema si dhuna në familje, trafikimi, shkaqet dhe pasojat, të drejtat e fëmijëve, menaxhimi i ankthit dhe i stresit, abuzimi me substancat, përfshirja dhe diskriminimi, disiplina pozitive etj.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, me rastin e 1 qershorit, ditës së fëmijëve ka organizuar konferencën kombëtare “Të drejtat e fëmijëve prioritet për integrimin evropian”, në të cilën është prezantuar raporti i parë për monitorimin e ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Aty janë sjellë në fokus edhe problematikat kryesore, përfshi edhe mënyrën sesi Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës realizojnë procesin e ndihmës dhe referimit të fëmijëve në nevojë.

Aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga qendrat dhe organizatat partnere

Organizata “Të ndryshëm & Të barabartë”, në bashkëpunim me Njësinë Antitrafik dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kanë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të projektit “Respektimi i të drejtave të viktimave në Shqipëri – T’i japim fund stigmës”. Produkt i këtij projekti është fotonovela “Kjo është historia ime”- një histori e vërtetë e një viktime trafikimi- e cila është publikuar në 1000 kopje dhe shërben si një mjet ndërgjegjësues për fenomenin e trafikimit dhe stigmën e fortë që ai mbart. Kjo fotonovelë ka qenë lajtmotivi i një sërë workshopesh të organizuara:

- Në 12 shkolla të mesme në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë, me pjesëmarrjen e rreth **360 nxënësve**.
- Në trajtën e forumeve me komunitetin në Tiranë, Elbasan, Vlorë me pjesëmarrjen e rreth **167 personave**.
- Me **74 punëdhënës**, përfaqësues të biznesit në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë.

Gjithashtu, “Të ndryshëm & Të barabartë” ka zhvilluar një workshop në Tiranë, me mbështetjen e Njësisë Antitrafik, me pjesëmarrjen e 36 pjesëmarrësve, aktorë të rëndësishëm që operojnë në fushën e antitrafikimit. Ky workshop shërbeu për të prezantuar dhe ndarë aktivitetet e realizuara dhe për të diskutuar sesi bashkërisht dhe institucionalisht mund të adresohet më tej stigma ndaj viktimës së trafikimit.

Në një fazë të dytë të shtrirë gjatë shtatorit 2012 e në vazhdim, është ribotuar fotonovela në 2000 kopje për t’u shpërndarë gjatë aktiviteteve të fazës së dytë, është përgatitur dhe botuar një fletëpalosje në 2500 kopje dhe një poster në 500 kopje me temë bazë trafikimin e personave dhe janë organizuar tri workshope me nxënës të shkollave të mesme dhe përfaqësues të Zyrës së Punës në qytetin e Beratit me pjesëmarrjen e rreth 100 personave. “Të ndryshëm & Të barabartë” dhe Njësia Antitrafik janë duke planifikuar ta shtrijnë këtë projekt edhe në grupe të tjera, si dhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

Qendra Psiko-Sociale “Vatra” ka organizuar bashkë me World Vision Vlorë një fushatë 1-ditore në Ditën Europiane Antitrafikim në ambientet e Pallatit të Sportit në qytetin e Vlorës me

shpërndarje fletëpalosjesh për informimin e publikut mbi fenomenin e trafikimit por edhe mbi shërbimet e organizatave përgjegjëse të aktivitetit, me mesazhe përmes disa videove të qendrës Vatra mbi trafikimin, si edhe bisedave të ndryshme që stafi realizoi me qytetarë të ndryshëm që u bënë pjesë e këtij aktiviteti.

World Vision vazhdon të punojë ngushtësisht me 3 Grupet Komunitare në Bathore (Bashkia Kamzë), Bregu i Lumit (Bashkia Tiranë) dhe Guerile (Bashkia Shkodër), si dhe me 4 grupe të edukatorëve bashkëmoshatarë të cilët janë fëmijë të moshave 12-16 vjeç, të zgjedhur nga vetë bashkëmoshatarët e tyre, për t'u informuar rreth çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe për ta transmetuar më tej këtë informacion në komunitet. Këto grupe përbëhen nga persona që kanë role kyçe në komunitet, të cilët, të informuar në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, përpiqen që të marrin një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve të trafikuar apo në rrezik trafikimi.

Qendra Ditore e Grave, pjesë e Tjetër Vizion, ka realizuar, për periudhën e raportimit, **79 takime ndërgjegjësuere në klasat 9-vjeçare të qytetit të Elbasanit**. Tema bazë ishte “Të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentit” dhe në to morën pjesë 1960 nxënës.

Qendra Tjetër Vizion po mbështet konsolidimin e rrjetit të Klubeve të Grave në zonat rurale të Elbasanit dhe ka organizuar **12 takime** ku janë trajtuar çështje të tilla si dhuna në familje, dhuna me bazë gjinore, njohja me ligjin e dhunës në marrëdhëniet familjare, planifikimi familjar etj. Gjithashtu, kjo qendër ka organizuar dy takime me gratë pjesëmarrëse në kurset profesionale të Qendrës Ditore të Grave, ku është diskutuar adresimi i problemeve të diskriminimit dhe stigmatizimit me të cilin përballen viktimat e trafikimit në vendin e punës.

Gjatë periudhës së raportimit, Terre des Hommes ka organizuar 44 aktivitete ndërgjegjësuere në bashkëpunim me struktura të ndryshme, si Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës, shërbimin psikologjik në shkolla, policinë etj., me tema të lidhura me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës, adresimi i pasojave negative të formave të ndryshme të abuzimit me fëmijën, shfrytëzimin dhe trafikimin e fëmijëve. Kjo organizatë mbështet fort ngritjen e Grupeve Komunitare të Këshillimit dhe Grupeve për të Drejtat e Fëmijëve dhe konsolidimin e grupeve tashmë ekzistuese. Ajo ka asistuar në konsolidimin e 7 (shtatë) Grupeve Komunitare të këshillimit ekzistuese në Elbasan, Durrës, Pogradec, në ngritjen e 4 (katër) prej tyre në Tiranë, Gjirokastër, Korçë dhe Sarandë, si dhe në ngritjen e 9 (nëntë) Grupeve për të Drejtat e Fëmijëve. Si rezultat i këtyre aktiviteteve, është rritur numri i fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje nga të cilët:

- 18 janë referuar për regjistrim në Gjendjen Civile
- 9 (nëntë) janë referuar në qendrat shëndetësore për t'u pajisur me librezë shëndeti
- 9 (nëntë) janë referuar për trajnim profesional
- 8 (tetë) janë referuar në sistemin shkollor
- 6 (gjashtë) në kopshte etj.

3. Edukimi

Shfrytëzimi i sistemit arsimor për të informuar dhe ndërgjegjësuar nxënësit dhe mësuesit mbi çështjet e të drejtave njerëzore dhe ato gjinore, si dhe trafikimin e personave, është një fokus i veçantë i parandalimit të këtij fenomeni.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës vazhdon zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të “Programit kombëtar për braktisjen zero 2009-2013”.

Vazhdon mbështetja e arsimit të nxënësve të shtresave në nevojë në bazë të VKM Nr. 170, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit para-universitar”, vendim i cili siguron mbulimin 100% të çmimit të blerjes së teksteve shkollore për familjet në nevojë.

Në kuadër të rishikimit të kurrikulës së arsimit parauniversitar, Instituti i Zhvillimit Arsimor do të bëjë rishikimin e programeve duke pasur prioritet pasurimin e tyre me elemente të njohjes së fenomenit të trafikimit dhe parandalimin e tij. Në arsimin 9-vjeçar, tema mbi trafikimin dhe parandalimin e tij tashmë është pjesë e kurrikulave përkatëse, konkretisht në programin e lëndës së Qytetarisë. Kjo është në vazhdë të marrëveshjes së lidhur në 2011 midis Ministrisë së Brendshme/Njësisë Antitrafik dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Punësimi

Programi i punësimit për 6-mujorin e parë 2012 vazhdon të mbështetet në objektivat e Strategjisë së Punësimit dhe Formimit Profesional 2007-2013. Kryesisht, politikat shtetërore të punësimit përfshijnë Politikat Aktive, që përfshijnë masat për nxitjen e punësimit, dhe Politikat Pasive, pra sigurimin e mbështetjes me të ardhura.

Programet e krijimit të vendeve të reja të punës

Në 11.01.2012 është miratuar VKM Nr. 27 “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”. Sipas këtij programi, punëdhënësit e këtyre grupeve do të përfitojnë mbështetje financiare në masën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, katër paga minimale, si dhe mbështetje punësimi për ndërmarrjet dhe mikrondërmarrjet.

Viktimat e trafikimit vazhdojnë të përfitojnë falas kurse të formimit profesional të ofruara nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik, MPÇSSHB, duke ndihmuar në riintegrimin sa më të shpejtë dhe të plotë të tyre në shoqëri.

5. Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të aktorëve që punojnë me kategoritë e pambrojtura

Njësia Antitrafik, në bashkëpunim me IOM, kanë zhvilluar trajnimet e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit (miratuar me VKM Nr. 582, datë 27.07.2011) në 12 qarqet e vendit në periudhën

shkurt-maj 2012, duke përfshirë të gjitha strukturat shtetërore dhe jo shtetërore përgjegjëse, sipas PSV, për identifikimin fillestar dhe formal të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Duke qenë se një fokus i rëndësishëm i PSV është identifikimi fillestar, PSV janë një mjet mjaft efikas parandalimi për krimin e trafikimit. Ato janë pasuar nga hartimi i disa broshurave, disa forma të thjeshtëzuara dhe të shkurtuara të PSV-ve për secilën strukturë shtetërore përgjegjëse për procesin, të cilat tashmë janë botuar dhe janë gati për shpërndarje.

Njësia Antitrafik, në bashkëpunim me organizatën “Të ndryshëm & Të barabartë” dhe me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, kanë organizuar **4 trajnime për stafin e Zyrave Rajonale të Punësimit dhe përfaqësues të bizneseve në Durrës, Shkodër, Lezhë dhe Fier** në periudhën prill-qershor 2012. **Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet është 109** dhe, si rezultat i tij, pjesëmarrësit janë njohur me nevojat dhe specifikat e grupit të viktimave të trafikimit, pasojat e trafikimit dhe parimet etike të punës me viktimat e trafikimit, si dhe me rëndësinë e punësimit në procesin e riintegrit të këtyre viktimave në shoqëri.

Njësia Antitrafik ka bashkë-organizuar me Terre des Hommes në shtator 2012 trajnimin “Procesi i vlerësimit në trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me fokus dhunën dhe trafikimin” për **26 administratorë socialë** të qarkut Tiranë dhe Durrës, me qëllim përmirësimin e njohurive mbi procesin e vlerësimit, treguesit e vlerësimit të riskut, identifikimin fillestar dhe atë formal për rastet e trafikimit etj.

Në datat 4-5 prill, Departamenti i Trajnimeve të Policisë, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe IOM, kanë organizuar një trajnim dy ditor në Vlorë me **20 prokurorë dhe oficerë të Policisë së Shtetit** me temë “Aspekte teorike dhe praktike mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe praktikat juridike”.

Ministria e Arsimit, mbështetur nga IOM, ka organizuar tri trajnime në qarqet Kukës, Korçë dhe Gjirokastrë me pjesëmarrjen e 105 drejtorëve, mësuesve dhe psikologëve të shkollave të mesme në zonat urbane dhe rurale. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë zhvillimi i shprehive për të identifikuar dhe referuar viktimat e trafikimit, si dhe njohja me përgjegjësitë e tyre specifike për ta raportuar trafikimin e fëmijëve dhe për të marrë masa për parandalimin e tij.

Njësia Antitrafik, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe IOM kanë organizuar në datën 15 maj 2012 një trajnim një ditor për prokurorët dhe gjyqtarët e Gjykatës për Krimet e Rënda dhe të Apelit për Krime të Rënda Tiranë me temë “Forcimi i kapaciteteve antitrafikim në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikat gjyqësore”. Synimi i këtij trajnimi ishte dhe dalja në konkluzione konkrete mbi ndryshimet e mundshme në legjislacion për veprën penale të trafikimit. **Numri i pjesëmarrësve në këtë trajnim ishte 41.**

Në datat 17-18 dhjetor, Njësia Antitrafik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me Terre des Hommes, World Vision dhe Shkollën e Magjistraturës, kanë organizuar trajnimin me temë “Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve për trafikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve” për **35 prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore**. Temat e trajtuara në të kanë të bëjnë me trafikimin e personave, aspekte të hetimit dhe të gjyqimit të këtyre rasteve, me një fokus të veçantë tek trafikimi i të miturve.

Sektori i Luftës Kundër Trafikeve të Paligjshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në kuadër të parandalimit të fenomenit të trafikimit, ka ngritur Grupin Ndërinstitucional të Punës “Për marrjen e masave për implementimin e Konventës së Bashkëpunimit Policor për Vendet e Evropës Juglindore” me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme. Qëllimi kryesor i këtij grupi do të jetë përfshirja në legjislacionin e brendshëm të neneve të Konventës së sipërpërmendur, me qëllim që, në një të ardhme të shpejtë, të funksionojnë edhe në Shqipëri Grupet e Përbashkëta Hetimore në luftën kundër trafikimit të personave, trafikimit të lëndëve narkotike dhe terrorizmit. Gjithashtu, janë parashikuar në vazhdimësi trajnime të strukturave antitrafik në qarqe për rritjen e njohurive në luftën kundër trafikimit të fëmijëve, femrave dhe personave.

Në dhjetor 2012, Policia e Shtetit ka firmosur dy marrëveshje bashkëpunimi me qendrën psiko-sociale “Vatra”, Vlorë, për mbrojtjen, mbështetjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe rritjen e kapaciteteve të strukturave të policisë në nivel lokal mbi njohjen e të drejtave të këtyre viktimave. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve ka qenë ngritja e një bashkëpunimi efektiv mes dy firmëtarëve për të njohur më mirë të drejtat e viktimave dhe për t’u ofruar atyre shërbime cilësore në përputhje me këto të drejtave. Në vijim të tyre, janë botuar dhe shpërndarë një poster, broshurë dhe fletëpalosje të titulluar “Informohu dhe kërko!” për oficerët e policisë dhe viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, ku do të informohen këto dy grupe specifike mbi të drejtat e viktimave të trafikimit dhe detyrimet e strukturave të policisë karshi tyre.

Njësia Antitrafik, në bashkëpunim me OSBE, vazhdon të zbatojë projektin në lidhje me parandalimin e shfrytëzimit për punë, veçanërisht të fëmijëve. Ky projekt ka pasur për qëllim ngritjen e kapaciteteve të inspektorateve të punës. Është hartuar një pyetësor dhe iu është administruar të gjithë inspektorateve rajonale të punës si një proces gjetjesh faktesh mbi situatën e trafikimit për qëllime shfrytëzimi për punë në Shqipëri. Bazuar në problemet dhe gjetjet e pyetësorit, janë hartuar modulet e trajnimit dhe janë zhvilluar katër trajnime në rang vendi (një trajnim për tri qarqe). Në këto trajnime kanë marrë pjesë **120 përfaqësues të strukturave përgjegjëse antitrafikim**, nga të cilët **20 inspektorë pune**.

Ministria e Mbrojtjes ka zhvilluar në prill 2012 disa sesione informimi për personelin e Komandës së Forcës Detare dhe reparteve vartëse të saj me qëllim sensibilizimin në lidhje me fenomenin e trafikimit të personave dhe mënyrat e parandalimit të implikimit të mundshëm të efektive të Forcës Detare. Gjithashtu, është organizuar edhe takimi mes drejtuesve të Shtabeve të Forcave të Armatosura të vendeve ballkanike me temë “Për kërcënimet asimetrike”, ku, ndër të tjera, është trajtuar edhe trafikimi i personave, si fenomen kërcënues për sigurinë, dhe çështje të bashkëpunimit rajonal për luftimin e tij.

Qendra “Shtëpia e Ngjyrave”, me dy qendra në kompozimin e saj, *Qendra Ditore* dhe *Qendra e Emergjencës*, vazhdon të jetë funksionale edhe gjatë vitit 2012 në bazë të marrëveshjes së lidhur midis Bashkisë së Tiranës, UNICEF-it dhe organizatës ARSIS. Kjo qendër ka ofruar një varietet shërbimesh për rreth **200 fëmijë, nëna të reja apo shtatzëna**. Mbi këtë marrëveshje trepalëshe pilotohet strehimi i emergjencës 24 orësh për fëmijët në gjendje të skajshme vështirësie dhe rreziku dhe për nënat e tyre, sipas rastit. Kohëzgjatja maksimale në Qendrën e Emergjencës është deri në 72 orë, kohë gjatë së cilës bëhet trajtimi i menjëhershëm i krizës dhe identifikohen

sistemet e referimit dhe zgjidhjet potenciale të problemit. Për kohën e raportimit, kjo qendër emergjencash ka trajtuar **41 fëmijë**, 7 (shtatë) nga të cilët viktimat apo viktimat të mundshme të trafikimit.

6. Veprimtaria e Komiteteve Rajonale Antitrafikim (KRAT)

Komitetet Rajonale Antitrafikim, strukturat më të rëndësishme parandaluese në nivel vendor, kanë vijuar rregullisht veprimtarinë e tyre, duke përcjellë informacione periodike pranë Njësisë Antitrafik. Edhe gjatë vitit 2012 i është kushtuar një vëmendje e veçantë rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit të punës të të gjitha institucioneve të përfaqësuara në tryezat teknike, si një parakusht për të pasur sukses në luftën kundër trafikimit të personave.

Në mënyrë konsistente vihet re një sensibilizim gjithnjë e më në rritje i Komiteteve Rajonale Antitrafikim për ekzistencën e trafikimit të brendshëm si një formë e trafikimit me të cilën ata ndeshen më tepër gjatë punës së tyre, kjo edhe si rezultat i trajnimeve të organizuara në 12 qarqet në lidhje me Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit gjatë periudhës shkurt-maj 2012.

Në mënyrë të përsëritur qëndron nevoja për një zë të veçantë në buxhetin e institucionit të prefekturës për nevojat financiare dhe materiale të KRAT-ve dhe për përfshirjen e disa përfaqësuesve të strukturave të tjera të pushtetit vendor dhe disa institucioneve të pavarura që mund të ofrojnë asistencë në parandalimin e fenomenit të trafikimit.

Në lidhje me disa aktivitete kryesore në nivel lokal, mund të sjellim në vëmendje:

- Në **Qarkun Berat**, ka filluar një bashkëpunim i ngushtë me Sistemin e Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Bashki dhe Komisionin e Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve në Qark me një fokus të veçantë fëmijët Romë, për të evidentuar dhe lehtësuar nevojat e tyre. Në kuadër të Dekadës së Përfshirjes së Romëve 2010-2015, ky qark ka ndërmarrë një nismë për një studim në këtë qark ku përfshihen përqendrimet, të dhënat demografike, arsimore, të punësimit, mbrojtjes sociale, strehimi, infrastruktura, shëndeti dhe përfshirja sociale e komunitetit Rom. Ky studim do t'u shërbejë strukturave vendore dhe qendrore për hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e jetesës së Romëve. Një sugjerim i këtij qarku ka të bëjë me zgjerimin e KRAT-it Berat me përfshirjen në to të Këshillave të Qarkut, nënprefektëve dhe përfaqësuesve nga Dhoma e Avokatisë dhe Dhoma e Tregtisë, pasi të gjithë këta mund të ofrojnë ndihmë konkrete për personat në nevojë dhe rrezik trafikimi. Rreth **200 gra dhe vajza** nga shtresat në nevojë kanë përfunduar kurse profesionale nga strukturat e Komitetit Rajonal në bashkëpunim me shoqatën “Mbrojtja e të drejtave të grave dhe vajzave qytetare dhe fshatare” dhe për një pjesë të tyre është ofruar edhe punësim në biznese private. Ato kanë marrë pjesë edhe në trajnime lidhur me trafikimin e personave.
- Në **Qarkun Dibër**, në bashkëpunim me OJF “Partnerë për fëmijët” dhe me mbështetjen e UNICEF, janë krijuar disa grupe të vogla multidisiplinare me përbërje të strukturave të Komitetit Rajonal Antitrafikim, të cilat janë trajnuar lidhur me të drejtat e fëmijëve, njohjen e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve dhe adresimin e nevojave të tyre. Si rezultat, është

mundësuar regjistrimi i **dy vajzave 8 dhe 9 vjeç** në shkollë dhe janë adresuar tri raste të fëmijëve në nevojë, sipas problematikës specifike. Në kuadër të projektit “Kujdesi për fëmijët me aftësi të kufizuara” në zonat Peshkopi, Muhur dhe Sllovë, ka filluar trajnimi i profesionistë të arsimit, shëndetësisë dhe të pushtetit lokal mbi çështje të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përfshirja në aktivitete sociale të 180 fëmijëve me aftësi të kufizuara, po punohet për krijimin e grupeve vetëmbrojtëse të familjeve të këtyre fëmijëve dhe është hapur një adresë në rrjetin social Facebook me qëllim informimin mbi të drejtat e këtij grupi të cënueshëm dhe publikimin e aktiviteteve organizuar në këtë kontekst. Drejtorja Arsimore Rajonale, në bashkëpunim me OJF aktive në zonë, ka organizuar **shkolla verore ku kanë marrë pjesë rreth 4000 fëmijë** nga komuna të ndryshme, të cilat kanë pasur për qëllim edukimin e fëmijëve, aftësimin e tyre për jetën, njohjen e të drejtave, ndërgjegjësimin e prindërve mbi fenomene që mbartin një rrezik të lartë në jetën e fëmijëve, disiplinimin etj. Gjithashtu, kjo Drejtori në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër, kanë miratuar një plan të përbashkët pune në zbatim të programit “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për droga”, i cili është zbatuar në gjashtë shkolla 9-vjeçare dhe ku kanë marrë pjesë 455 nxënës.

- Në **Qarkun Durrës** janë organizuar një numër aktivitete ndërgjegjësuere për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve dhe trafikimin e personave në shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme, kategoritë e cënueshme, prindërit e fëmijëve të kopshteve shtetërore dhe private, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale, Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, Zyrën për Barazinë Gjinore dhe OJF që operojnë në këtë fushë. Si rezultat, janë sensibilizuar **2500 nxënës dhe rreth 200 gra dhe fëmijë** nga grupet e cënueshme. Në Ditën Evropiane Antitrafikim, 18 tetor 2012, është zhvilluar një aktivitet ndërgjegjësuere “Trafikimi I qenieve njerëzore” me nxënës të klasave X dhe XI në disa shkolla të qytetit. Këto fushata ndërgjegjësuere, të pasuara edhe me broshura dhe fletëpalosje, janë shtrirë edhe në 18 qendra shëndetësore në Qarkun Durrës për të rritur vetëdijen e stafit se ata kanë një detyrë shumë të rëndësishme në procesin e identifikimit të personave që rrezikojnë të trafikohen gjatë punës së përditshme të tyre. Drejtorja Rajonale e Shëndetësisë ka alokuar një buxhet për përgatitje fletëpalosjesh mbi trafikimin, të drejtat e fëmijëve dhe dhunën në familje. Në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë, në Panairin e Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor, në një stendë të veçantë u vendosën materiale informuese mbi trafikimin, dhunën dhe të drejtat e fëmijëve. Gjithashtu, Zyra për Mbrojtjen e Fëmijëve ka zbatuar projektin 4-mujor “Krijimi i një sistemi të mirë-koordinuar referues midis pushtetit vendor dhe Drejtorisë Rajonale Durrës për reduktimin e braktisjes shkollore” në bashkëpunim me këtë drejtori arsimore. Në vijim, janë identifikuar fëmijët dhe familjet në rrezik dhe janë marrë masa për mbështetjen dhe përfshirjen e tyre në skemat e ndihmës ekonomike. Shtatë prej këtyre familjeve kanë përfituar deri tani nga ky projekt.
- Në **Qarkun Elbasan**, Komiteti Rajonal Antitrafikim, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Drejtorinë e Policisë së Qarkut, kanë zhvilluar një mori aktivitete ndërgjegjësuere në disa shkolla të Elbasanit për fenomenin e trafikimit. Në qershor, janë organizuar disa kampe ditore me shkollat 9-vjeçare, ku nxënësit janë përfshirë në aktivitete argëtuese dhe ndërgjegjësuere mbi dhunën dhe trafikimin e personave. Një problematikë e ngritur nga analiza e punës së Komitetit Rajonal Antitrafikim është ajo e fëmijëve që braktisin shkollën dhe që përfshihen në punë të ndryshme me dijeninë e prindërve dhe familjeve të tyre. Për adresimin e kësaj problematike, janë ndërmarrë takime të shumta me prindërit dhe fëmijët individualisht nga profesionistë të ndryshëm dhe janë ndërgjegjësuar

për rreziqet që sjell braktisja e shkollës dhe përfshirja në punë e fëmijëve nën moshën e lejuar.

- Në **Qarkun Fier**, ka pasur një bashkëpunim dhe koordinim efikas midis Komitetit Rajonal dhe strukturave të Policisë së qarkut në kuadër të implementimit të Patrullës së Përgjithshme dhe Filozofisë së Policimit në Komunitet, duke bërë të mundur shkëmbimin e informacionit dhe ndërhyrjen në kohë për parandalimin e disa krimeve. Një partneritet i suksesshëm është vendosur midis këtij Komiteti dhe medias lokale, e cila ka pasqyruar bashkëpunimet e mësipërme dhe ka sensibilizuar opinionin publik për rrezikun e këtij fenomeni. Strukturat vendore në këtë qark kanë punuar për ngritjen e kapaciteteve të tyre, konkretisht për hapjen e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel bashkie dhe komune, njësi përgjegjëse për identifikimin dhe asistencën e individëve dhe grupeve të cënueshme. Deri në fund të vitit 2012, në këtë qark janë ngritur dhe funksionojnë **10 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve**.
- Në **Qarkun Gjirokastër**, Drejtorja e Shëndetit Publik vazhdon të promovojë Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, pas trajnimit që ka marrë personeli i kësaj drejtorie për këto procedura. Policia e qarkut Gjirokastër, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Arsimore, kanë ndërmarrë një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuere për trafikimin e personave, prostitucionin, shfrytëzimin e të miturve për punë e lypje, duke i shtrirë ato në disa shkolla të qarkut dhe duke shënjestruar nxënësit e arsimit parauniversitar. Drejtorja Rajonale Arsimore u ka kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën, duke i dhënë përparësi punës me fëmijët Romë dhe Egjiptianë, gjë që ka bërë që, për periudhën e raportimit, të mos ketë asnjë braktisje shkolle nga nxënësit e këtij qarku. Fondacioni Nehemia, Gjirokastër, në bashkëpunim me Terre des Hommes janë duke zhvilluar një projekt për mbështetjen e kampeve verore dhe integrimin e komuniteteve të ndryshme të fëmijëve në Gjirokastër në aktivitete sociale, me një kapacitet prej 50 fëmijësh. Një problematikë shqetësuese e konstatuar nga Komiteti Rajonal Antitrafikim ka të bëjë me disa fëmijë romë që lypin në bulevardin kryesor të qytetit, në risk të lartë trafikimi për qëllime të ndryshme. Ata paraqesin një mori problemesh që prekin pothuajse të gjitha aspektet e jetës dhe kërkojnë një angazhim mjaft serioz dhe në disa plane të të gjitha strukturave përgjegjëse për mbrojtjen dhe asistencën ndaj shtresave në nevojë.
- Në **Qarkun Korçë**, Drejtorja Arsimore Rajonale vazhdon të bëjë evidentimin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe, në bashkëpunim me Zyrën e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkinë e qytetit, është bërë **rikthimi në shkollë i 30 prej këtyre fëmijëve**. Takime periodike janë realizuar edhe me prindërit e këtyre fëmijëve për t'i ndërgjegjësuar ata për faktorët që çojnë në braktisje shkollore. Në fokus të veçantë të takimeve të këtij Komiteti Rajonal kanë qenë fëmijët që lypin dhe i është mëshuar bashkëpunimit të mirëkoordinuar me policinë për ta eliminuar këtë fenomen të dukshëm. Një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuere janë zhvilluar nga anëtarë të Komitetit me komunitetin Rom, Egjiptian, gratë dhe fëmijët me problematika të mprehta në zonat rurale dhe ato të varfra të qarkut. Janë ngritur edhe kampe verore për këta fëmijë, duke i bërë ata pjesë të aktiviteteve argëtuese, si ndeshje futbollit, basketbollit, ekskursione etj. Tetë femra punëkërkuere të papuna, potencial trafikimi për komunitetin Rom dhe Egjiptian, kanë zhvilluar kursin për qepje-këpucë dhe, pas tij, janë punësuar me kontratë të rregullt, 22 persona janë trajnuar në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional në kurse kuzhine, hidraulik, elektrik. Njëqindetridhjetë persona janë asistuar për plotësim dokumentesh për punësim në Itali, nga të cilët 22 janë duke firmosur kontratën e punësimit. Qarku Korçë ka treguar një vëmendje të posaçme për ngritjen e Njësive për Mbrojtjen e

Fëmijëve në të gjitha njësitë vendore, duke i vlerësuar këto struktura si të domosdoshme për mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve në nevojë, por, në të njëjtën kohë, duke evidentuar edhe nevojën për ngritjen e kapaciteteve të tyre për sa i përket mënyrës së funksionimit dhe detyrat konkrete që këto njësi duhet të ndjekin. Gjatë 2012, nga puna e këtyre Njësive, familjet e fëmijëve potencialë trafikimi janë futur në skemën e ndihmës ekonomike.

- Në **Qarkun Kukës**, Komiteti Rajonal ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të shtresave në rrezik, duke evidentuar tipologjinë e këtyre grupeve. Gjithashtu, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ka bërë evidentimin e 500 fëmijëve në rrezik të lartë dhe të mesëm trafikimi. Në varësi të problematikës specifike, janë bërë përpjekje për t'i asistuar këto grupe si në plotësimin e nevojave bazë, ndërgjegjësimin e tyre për rreziqet që u kanosen etj. Komiteti Rajonal Antitrafikim evidenton në mënyrë të përsëritur nevojën për krijimin e një qendre pritëse për të strehuar dhe trajtuar raste imediate dhune, trafikimi etj.
- Në **Qarkun Shkodër** ka pasur një bashkëpunim efektiv mes Zyrës së Punës dhe Bashkisë Shkodër për të ngritur ura lidhëse midis subjekteve private dhe Bashkisë për punësim 1-vjeçar të kategorive të cenueshme, konkretisht fëmijëve Romë dhe atyre jetimë. Drejtoria Rajonale Arsimore ka zbatuar disa projekte konkrete për regjistrimin dhe rikthimin e fëmijëve Romë në shkolla, të cilat kanë rritur numrin e këtyre fëmijëve që frekuentojnë arsimin e detyrueshëm. Institucioni i Prefektit mbështet grupet komunitare të ngritura në bashkëpunim me OJF-të e zonës të cilat kanë për qëllim punën me grupet e fëmijëve në rrezik për përdorim droge, mosfrekuentim shkolle, trafikim etj.
- Në **Qarkun Tiranë**, Komiteti Rajonal Antitrafik vazhdon të jetë një partner i rëndësishëm në shumë aktivitete ndërgjegjësuere të Njesisë Antitrafik. Prefektura e Tiranës ka qenë bashkë-organizator i aktivitetit të 18 Tetorit, Ditës Evropiane Antitrafikim, bashkë me Njësinë Antitrafik, Fakultetin e Drejtësisë, Komisionerin Antidiskriminim dhe shoqatën “Të ndryshëm dhe të barabartë”. Kjo Prefekturë ka vazhduar fushatën ndërgjegjësuere “Arti i Autobusëve” me tematika kundër dhunës në familje dhe duhanpirjes, tashmë edhe në 16 komuna dhe 2 bashki të tjera të rrethit të Tiranës, pas realizimit të kësaj nisme brenda territorit të Bashkisë Tiranë. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe OSBE, është bërë ndërgjegjësimi i publikut nëpërmjet imazheve grafike të vendosura në autobusë me mesazhe kundër dhunës në familje dhe duhanpirjes. Komiteti Rajonal ka pasur në fokus të punës së vet edhe asistencën dhe nxitjen për ngritjen e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashki/komuna në të gjithë Qarkun. Si rezultat i kësaj pune, në bashkëpunim edhe me struktura të tjera, në **Qarkun e Tiranës janë ngritur 14 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve**.

7. Kryerja e kërkimit dhe mbledhja e të dhënave

Kërkimi është një nga aktivitetet më të rëndësishme në parandalimin e trafikimit të personave. Vetëm duke e kuptuar plotësisht fenomenin e trafikimit mundësohet njohja e realitetit në vend, ngritja e politikave efektive antitrafikim dhe vlerësimi i herëpashershëm i masave kundër trafikimit të personave.

Organizata “Të ndryshëm & Të barabartë” ka ndërmarrë një kërkim mbi trafikimin e meshkujve në Shqipëri dhe nga Shqipëria. Ky kërkim ka për qëllim të njohë trafikimin e meshkujve dhe si shfaqen dinamikat e kësaj forme trafikimi në Shqipëri, si dhe të ndërgjegjësojë meshkujt e

trafikuar për gjendjen në të cilën kanë kaluar dhe për ndihmën që ata mund të përfitojnë. Të dhënat dhe rezultatet e këtij studimi do të bëhen të njohura gjatë vitit 2013.

Organizata IOM ka ndërmarrë një kërkim mbarëkombëtar për identifikimin e formave të ndryshme të shfrytëzimit, përfshirë trafikimin e meshkujve dhe fëmijëve, si dhe praktikave të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të shfrytëzuara. Në bazë të rezultateve të kërimit janë planifikuar të organizohen nga nëntori 2012-shkurt 2013 tri fushata me qëllim:

- Ngritjen e një modeli Komiteti Rajonal Antitrafikim në nivel komune për punë parandaluese në komunat dhe bashkitë e Prefekturës Tiranë. Përgjegjës për implementimin e këtij projekti është “Të ndryshëm & Të barabartë”. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar 14 takime me njësitë vendore të qarkut të Tiranës ku kanë marrë pjesë **364 përfaqësues nga këto njësi, shkollat, komisariatet e policisë, qendrat shëndetësore dhe organizatat jofitimprurëse**. Qëllimi i takimeve ka qenë informimi dhe ndërgjegjësimi i tyre për çështje të mbrojtjes së fëmijëve dhe parandalimit të trafikimit, si dhe shkëmbimi i kontakteve për mirëkoordinimin e punës.
- Ngritjen e Grupeve Vigjilente Komunitare në Elbasan dhe Korçë, zbatuar nga Tjetër Vizion. Nëpërmjet këtyre grupeve, synohet që të rritet ndërgjegjësimi lidhur me trafikimin e personave dhe të merren përgjegjësi për ruajtjen e sigurt të komunitetit nga ky fenomen. Gjithashtu, një qëllim tjetër i këtyre grupeve është forcimi i lidhjeve midis anëtarëve të Komiteteve Rajonale Antitrafik të Elbasanit dhe Korçës, në mënyrë që të rritet numri i raportimeve lidhur me trafikimin, ofrimin e ndihmës dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit. Një rezultat i dukshëm është ngritja e kapaciteteve lidhur me çështjen konkrete të 40 anëtarëve të Komiteteve Rajonale të dy qarqeve, si dhe ndërgjegjësimi i **6000 anëtarëve të komuniteteve përkatëse**.
- Informimin e viktimave të trafikimit mbi të drejtat që kanë dhe oficerëve të policisë mbi detyrimet në raport me to. Ky projekt zbatohet nga qendra psiko-sociale “Vatra” në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky projekt ka dy faza: gjatë fazës së parë kanë filluar diskutimeve dhe nga ekspertët e fushës në forumet e ngritura posaçërisht me qëllimin e hartimit të tre materialeve, një poster, një fletë-palosje dhe një broshurë. Këto tre materiale synojnë viktimat e trafikimit, duke i informuar ato për të drejtat që ato kanë në gjithë procesin ku mund të përfshihen, si dhe oficerët e policisë për detyrimet që ata kanë në këtë kuadër. Ndërkohë që faza e dytë vijoi me shpërndarjen e këtyre materialeve në 12 qarqet e vendit.

Njësia Antitrafik ka ofruar mbështetjen e saj në çdo hap të procesit kërkimor për të dyja organizatat e sipërpërmendura.

8. Regjistrimi

Ministria e Brendshme, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, ka ndërmarrë disa masa agresive për regjistrimin e pjesës së paregjistruar të popullsisë, duke filluar nga amendimet e bëra ligjit “Për Gjendjen Civile” në 2008 e deri në miratimin e një sërë aktesh nënligjore dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes strukturave shtetërore dhe jo shtetërore të përfshira në procesin e regjistrimit. Njësia Antitrafik ka marrë një rol lideri në lehtësimin dhe mundësimin e regjistrimit të rasteve të mbartura ndër vite dhe që nuk kanë gjetur zgjidhje deri në këtë kohë. Konkretisht:

- Njësia Antitrafik ka nxitur dhe mbështetur Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në hartimin dhe miratimin e Udhëzimit Nr. 7, datë 10.01.2012 “Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve që do të plotësohen nga përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe të bashkive/njësive bashkiake/komunave për rastet e fëmijëve të gjetur dhe fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile”. Nëpërmjet këtij Udhëzimi, synohet ulja dhe eliminimi i rasteve të paregjistruara të fëmijëve të gjetur dhe të braktisur nga nëna.
- Miratimi në 2011 i Marrëveshjes së përbashkët midis Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe qendrës “Shërbimi Ligjor Falas” i ka hapur rrugë regjistrimit të fëmijëve të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pengesë për të cilën kanë qenë mungesa e aktit të lindjes ose dokumentacionit tjetër të nevojshëm nga ana e prindërve. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, shërbimet tona konsullore sigurojnë dokumentacionin nga shërbimi shëndetësor i vendit ku ka ndodhur lindja e fëmijës, qendra “Shërbimi Ligjor Falas” mbulon shpenzimet për sigurimin e këtij dokumentacioni dhe Ministria e Brendshme bën regjistrimin nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.
- Vazhdon të zbatohet me sukses modeli i ri i dokumentit “Certifikatë-Asistencë në lindje” miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në dhjetor 2011 me Urdhrin Nr. 508, datë 07.12.2011. Duke pasur si qëllim një evidentim më të mirë të lindjeve të fëmijëve, nëpërmjet këtij dokumenti, ulen mundësitë për mosregjistrim të fëmijëve të sapolindur, duke përfshirë në të dy elemente shtesë, siç janë numri i identitetit të nënës dhe mbiemri i vajzërisë së saj.

Në zbatim të akteve të mësipërme, për periudhën e raportimit, është bërë i mundur regjistrimi i rreth **270 rasteve të fëmijëve të paregjistruar**.

Qendra Shërbimi Ligjor Falas është një ndër bashkëpunëtorët e Njesisë Antitrafik që lobon fort për reduktimin në zero të të gjitha rasteve të paregjistruara në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri. Kjo qendër ka asistuar zyrat e Gjendjes Civile në shkallë vendi me trajnime mbi ligjin e Gjendjes Civile dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe ka kryer një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuere të komuniteteve të cënueshme në qarqet Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Fier për t’i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e procesit të regjistrimit dhe rrugën sesi realizohet ai. Ministria e Brendshme e ka mbështetur qendrën “Shërbimi Ligjor Falas” në të gjitha hapat për zgjidhjen e rasteve problematike për regjistrim. **Nga 270 rastet e fëmijëve të regjistruar gjatë këtij viti, 140 janë zgjidhur në kuadër të marrëveshjes me Shërbimin Ligjor Falas.**

Në kuadër të iniciativës “Dekada Rome” me lider në Shqipëri Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka marrë pjesë aktive në takimet e zhvilluara, duke nxitur të gjithë drejtuesit e shoqatave të komunitetit Rom të paraqesin në zyrat e gjendjes civile përkatëse ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile listat e fëmijëve të paregjistruar dhe të gjithë dokumentacionin e disponueshëm.

Organizata ARSIS vazhdon të ofrojë këshillim ligjor, lehtësim dhe ndjekje të procesit të regjistrimit të rasteve problematike. Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me Sektorin e të Miturve dhe Dhunës në Familje në Policinë e Qarkut

Tiranë, kjo organizatë ka përfunduar regjistrimin e tre fëmijëve. Ndërkohë që organizata Terre des Hommes ka identifikuar 36 raste problematike të paregjistruara, 8 (tetë) prej të cilave janë zgjidhur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

9. Rritja e përfshirjes sociale të grupeve në nevojë dhe fëmijët në rrezik trafikimi

Në zbatim të ligjit Nr. 10347 datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe me nxitjen e Ministrisë së Brendshme për strukturat vendore në varësi të saj, gjatë vitit 2012 numri i Njësive për Mbrojtjen e të Fëmijës në nivel bashkie/komune ka njohur një rritje mjaft të dukshme. Nga 28 që ishte numri i tyre në 2011, deri në fund të vitit 2012, ky numër ka arritur në 100. Impakti i tyre ka qenë i dukshëm, megjithëse brenda një kohe relativisht të shkurtër. Ka reagime pozitive ndaj punës së këtyre njësive rishtare si nga Policia e Shtetit, ashtu edhe nga OJF të ndryshme që bashkëpunojnë në fushën e trafikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve. Megjithatë Qarku i Tiranës paraqet nevojën më të madhe për më tepër Njësi për Mbrojtjen e Fëmijës edhe për shkak të problematikës së gjerë dhe të dendur me të cilën hasen fëmijët dhe grupet në nevojë. Deri në periudhën e raportimit, për Qarkun e Tiranës, janë ngritur 2 NJMF në dy minibashki (konkretisht minibashkinë 4 dhe 9), në Bashkinë Kamëz dhe Kavajë dhe në 10 komuna (Paskuqan, Bërshullë, Bërzhitë, Dajt, Ndroq, Petrelë, Vaqar, Zall-Herr, Kryevidh, Synej).

Në zbatim të Urdhrit të përbashkët Nr. 125, datë 23.08.2012 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të abuzimit” mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, **Policia e Shtetit ka bërë identifikimin e 30 fëmijëve që lypnin në rrugë.** Në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror, tre prej tyre janë akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, dy prej tyre në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër dhe një në Shtëpinë e Foshnjës Sauk-Tiranë. Ndërkohë që rastet e tjera u janë lënë në kujdes familjeve të tyre dhe ndiqen nga strukturat e Shërbimit Social Shtetëror.

Në qytetin e Elbasanit, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe me OJF lokale, kanë ngritur një grup pune me qëllim hapjen e programit “Shansi i Dytë”, si rezultat i implementimit të të cilit janë asistuar **8 (tetë) fëmijë Romë.**

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në minibashkinë 11, Tiranë, në bashkëpunim me Terre des Hommes kanë mbështetur aktivisht, kryesisht me ushqim, një grup prej 57 Romësh të evakuuar nga vendet ku ata banonin.

Bashkia Korçë, në bashkëpunim me Fondacionin Emanuel, kanë hapur një qendër ditore për 30 fëmijë në nevojë, duke i mbështetur ata me ushqim, veshmbathje, si dhe duke u ofruar atyre kontrolle mjekësore. Në bazë të bashkëpunimit të vendosur midis Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës në këtë Bashki dhe Institutit të Shëndetit Publik, fëmijët e familjeve Rome në vështirësi përfitojnë kontrolle mjekësore pa pagesë.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në Fier, në bazë të gjetjeve të Forumit për Mbrojtjen e Fëmijës mbi dhunën në familje, ka përgatitur një projekt-propozim për të adresuar çështjet dhe problematikat e ngritura aty. Kjo Njësi ka ngritur ura bashkëpunimi me Zyrën e Punës për t’u ardhur në ndihmë grupeve në nevojë. Konkretisht po shikohet të rriten mundësitë e punësimit të

këtyre grupeve në kuadër të iniciativës për të ndërgjegjësuar bizneset lokale mbi çështjet sociale në përgjithësi dhe mbi çështjet e fëmijëve në veçanti.

10. Promovimi dhe zbatimi i Kodit Global të Etikës dhe kodit të sjelljes në turizëm

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Brendshme vazhdojnë të promovojnë dhe monitorojnë zbatimin e Kodit Global të Etikës dhe Kodit të Sjelljes për Parandalimin e Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve në Turizëm, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit mes saj dhe Ministrisë së Brendshme të vitit 2007. Të dyja këto dokumente mund të gjenden në gjuhën shqipe dhe angleze në faqet e internetit:

- http://www.mtkrs.gov.al/web/Marreveshje_bashkepunimi_706_1.php
- <http://www.rreth.net/ata/about-ata/code-of-ethics/>

Ministria e Turizmit, në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat, ka hartuar projektligjin e ri “Për turizmin”, i cili do të përfshijë në përmbajtje të tij edhe dy kodet e mësipërme, i cili pritet të miratohet gjatë 2013.

11. Rekomandime

- Vazhdimi i fushatave ndërgjegjëse me përfshirjen aktive të medias.
- Kryerja dhe nxitja e kërkimeve dhe studimeve serioze në fushën e trafikimit të personave për të bërë një hartim dhe planifikim efektiv të makropolitikave kundër trafikimit të personave.
- Ndërgjegjësimi që në moshë të herët i fëmijëve për të drejtat që ata gëzojnë dhe fuqizimi i tyre përmes sistemeve të mbrojtjes, nxitjes dhe favorizimit.
-
- Mbështetje për ngritjen e një sistemi kapilar efektiv parandalimi dhe mbrojtjeje sociale me fokus fëmijët dhe grupet e ndryshme në nevojë.

IV. KOORDINIMI

Koordinimi është një ndër katër shtyllat e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2012-2013. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2012, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik ka zhvilluar e drejtuar një sërë aktiviteteve me qëllim zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit dhe koordinimit mes të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë, të cilët janë të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave.

Paralelisht me ndjekjen e zbatimit në mënyrë rigoroze të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit 2011-2013, gjithashtu dhe të PSV-ve, ZKKA ka qenë plotësisht e angazhuar për të zbatuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, lidhur me marrjen e masave në luftën kundër trafikimit të personave, si edhe në drejtim të shmangies së mbivendosjes së përpjekjeve antitrafik në shkallë vendi dhe integrimin e tyre në nivel rajonal.

Më poshtë, jepet informacion mbi shtyllën e koordinimit për periudhën janar-dhjetor 2012, i strukturuar sipas institucioneve shtetërore dhe joshetërore, partnerë në koordinimin e çështjeve antitrafik.

1. KOORDINIMI I AKTORËVE ANTITRAFIK BRENDA VENDIT

a. Autoriteti Përgjegjës

Në bazë të Urdhrit me anë të të cilit ngrihet, Autoriteti Përgjegjës (AP) është struktura që trajton rastet e viktimave të trafikimit. Gjatë periudhës së raportimit, Autoriteti Përgjegjës është mbledhur në mënyrë të rregullt¹³, duke organizuar më shumë se **17 takime**.

Ai ka punuar intensivisht për koordinimin e kthimit, rehabilitimit, integrimin dhe ri-integrimin të individëve viktimat/viktima të mundshme të trafikimit. Në të gjitha rastet e koordinimit dhe ndihmës për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, AP i ka kushtuar vëmendje të veçantë zbatimit korrekt të Procedurave Standarde të Veprimit.

Autoriteti Përgjegjës gjithashtu ka asistuar strukturat e varësisë për referimin, kthimin e asistuar dhe ri-integrimin e rasteve nga Serbia, Anglia, Italia, Kosova dhe Greqia. Për periudhën janar – dhjetor 2012, janë shqyrtuar nga AP për identifikim formal gjithsej **42 persona**.

Gjatë periudhës së raportimit, Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka organizuar takime të shpeshta me AP, me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e mbledhjes së të dhënave për viktimat e

¹³ Sipas Urdhrit të Përbashkët, AP mbledhet 1 herë në çdo muaj.

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

trafikimit dhe reflektimin në të të informacionit të mbledhur gjatë zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit nga aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë. Me ndihmën e DPPSH/Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit, sugjerimet e aktorëve u konkretizuan në një bazë më të plotë dhe të përditësuar të grumbullimit dhe analizimit të të dhënave, i quajtur tani, Sistemi i Informacionit për Viktimat e Trafikimit (SIVET).

Ky sistem ka si synim kryesor, ndërtimin e një Sistemi të ri për Menaxhimin e të Dhënave dhe nxjerrjen e raporteve për Trafikimin e Qenieve Njerëzore, në bazë të procedurave dhe akteve ligjore në fuqi. SIVET ridizenjoi bazën e të dhënave me qëllim, përmbushjen e kërkesave të përdoruesve, si dhe raportimin e saktë dhe në kohë të të dhënave të regjistruara.

Ekspertë të IT-së të Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit, më **15.05.2012**, zhvilluan trajnimin për mënyrën e hedhjes së të dhënave dhe, në korrik 2012, ky sistem u bë plotësisht i përdorshëm dhe funksional. Hedhja e të dhënave nga AP bëhet nëpërmjet këtij sistemi dhe Zyra e Koordinatorit Kombëtar monitoron përdorimin e tij dhe përdor të dhëna të nxjerra prej tij

b. Mekanizmi Kombëtar i Referimit

Duke marrë në konsideratë eksperiencën disa-vjeçare në drejtim të identifikimit, referimit dhe ri-integrimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, punën e Autoritetit Përgjegjës me rastet konkrete, informacionet e marra nga të gjithë aktorët antitrafik në vend, përfshirë këtu problematikat dhe sfidat e hasura, rekomandimet dhe sugjerimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe mbi të gjitha zbatimi i PSV-ve, treguan nevojën e domosdoshme për ndryshim të MKR-së. Ky ndryshim duhet të përfshinte zgjerimin e anëtarëve, si dhe zgjerimin e fushës së veprimit të secilit prej tyre. Rrjedhimisht, ZKKA, duke vijuar traditën e saj të proceseve gjithëpërfshirëse, bëri të mundur përpilimin, konsultimin, negocimin dhe finalizimin e një marrëveshjeje të re për MKR-në, e cila u firmos më **15.06.2012** nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Prokuroria e Përgjithshme dhe World Vision.

Sipas parashikimeve të nenit 8 dhe 14 të MKR-së, secili prej nënshkruesve ka të drejtë të monitorojë zbatimin e saj, nëpërmjet caktimit të një zyrtari të vet si anëtar i Task Forcës për Monitorimin e MKR-së. Si Sekretariat Teknik i Task Forcës për Marrëveshjen, Njësia Antitrafik kërkoi zyrtarisht nominimin e personave nga secili prej firmëtarëve, dhe aktualisht është bërë i mundur caktimi i anëtarëve të Task-Forcës prej tyre. **Tashmë, mbledhja e parë e MKR-së u organizua më 21 mars 2013.**

c. Komitetet Rajonale Antitrafik

Në zbatim të Planit të Veprimit, gjatë periudhës së raportit, Njësia Antitrafik ka mbajtur kontakte të ngushta me Komitetet Rajonale Antitrafik (KRAT-et). Këto Komitete kanë raportuar rritje të pjesëmarrjes në to të përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe të shoqërisë civile.

KRAT-et kanë mbështetur Njësinë Antitrafik në organizimin e trajnimeve në qarqe, duke i shfrytëzuar ato edhe si forume të njohjes dhe diskutimit me aktorët që ndihmojnë kategori të ndryshme të pambrojtura.

Në fokus të punës koordinuese dhe parandaluese të KRAT-ve është edhe bashkëpunimi i Komiteteve Rajonale me OJF-të që operojnë në qarqet respektive, ku në themel të angazhimit të tyre kanë luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjatë vitit 2012, Komitetet Rajonale Antitrafik dhe Tryezat Teknike kanë zhvilluar takime periodike, sipas Planit Kombëtar të Veprimit 2011-2013¹⁴. Vlen të theksohet se takimet e Tryezave Teknike Antitrafik nuk janë zhvilluar vetëm sipas programit të punës të hartuar në fillim të vitit, por edhe me kërkesat e veçanta të aktorëve të saj për të trajtuar raste, të cilat konsiderohen si emergjente. Ndër KRAT-et më aktivë mund të përmendim: KRAT-Tiranë, Korçë dhe Elbasan dhe disa prej aktiviteteve kryesore të tyre janë:

1. KRAT-Tiranë, në bashkëpunim me ZKKA, ASHMDF, IOM, ARSIS dhe D&E, hartuan një plan pune lidhur me ngritjen e strukturave mbrojtëse dhe strukturave kundër trafikimit të personave pranë çdo Njësie të Qeverisjes Vendore të Qarkut Tiranë, sipas modelit ligjor të KRAT. Këto struktura, në përbërje të tyre kanë përfaqësues të Njësiave Bashkiake/Komunave, shkollave, qendrave shëndetësore dhe komisariateve, të cilët janë aktorë vendimtarë në adresimin e çështjeve antitrafik në nivel vendor. Gjatë muajit janar-shkurt 2013 u zbatua plani i punës, si dhe u organizuan **13 takime** në njësitë vendore/komuna dhe një takim përfundimtar me përfaqësues nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të Qarkut të Tiranës. Në 14 takimet morën pjesë rreth **364 pjesëmarrës**.
2. KRAT-Elbasan, për të menaxhuar sa më mirë situatën e trafikimit në qark, ka ngritur, në nivel nënprefekturash, Minitryezat antitrafik, të cilat drejtohen nga nënprefektët. Kjo risi ka rezultuar pozitive për punën në vazhdimësi pasi, tashmë nënprefektët, krahas raportimeve mujore pranë Institucionit të Prefektit, raportojnë edhe për problemet e trafikimit të personave në territorin që ata kanë në juridiksion. Për rrjedhojë, Komiteti Rajonal Antitrafik ka një informacion më të saktë, si edhe më të shpejtë në lidhje me situatën dhe problematikën e trafikimit.
3. KRAT-Korçë, në kuadër të “Dekadës së Përfshirjes së Romëve”, ka ngritur Bordin Koordinues Ndërsektoral, i cili merret me problemet e komunitetit rom e egjiptian për regjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile, për të luftuar braktisjen shkollore, si dhe për të parandaluar trafikimin e këtij target-grupi, si mjaft i rrisuar.

Siç edhe shihet, aktivitetet e këtyre KRAT-eve, janë praktika dhe qasje, të cilat vlen të zbatohen edhe në qarqet e tjera, pasi sjellin parandalim, identifikim, mbrojtje dhe riintegrim më efikas të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

¹⁴ Për më shumë informacion, referohu tek “Parandalimi”, lidhur me veprimtarinë e detajuar të Komiteteve Rajonale Antitrafik.

Një risi e koordinimit të veprimtarisë së aktorëve antitrafik në nivel qarku është dhe ngritja dhe funksionimi i Njërive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF). Pranë çdo Këshilli Qarku, në të 12 qarqet, ekzistojnë **12 Njësi** për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF), ndërsa në nivel bashkie/komune janë ngritur dhe funksionojnë **100 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve**. Vlerësojmë se miratimi i kuadrit ligjor për fëmijët, si dhe bashkëpunimi i ZKKA-së me KRAT-et, duke institucionalizuar strukturat për fëmijët në nivel vendor, kanë qenë një nxitje e rëndësishme për njësitë e qeverisjes vendore në marrjen e përgjegjësisë për mbrojtjen e fëmijëve, duke rritur ndjeshëm numrin e NJMF-ve të reja. Gjatë periudhës së raportimit, një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe mirëfunksionimit të Mekanizmit Multidisiplinar të Referimit në nivel lokal, duke zgjeruar rrjetin e aktorëve antitrafik.

d. Ngritja e kapaciteteve të aktorëve antitrafik

Ngritja e kapaciteteve është një aspekt tepër i rëndësishëm sa i përket parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave. Si e tillë, kjo çështje ka një vëmendje të veçantë nga ZKKA. Rrjedhimisht, gjatë periudhës së raportimit, kjo zyrë ka organizuar në bashkëpunim me organizata dhe struktura shtetërore trajnime me tematika të ndryshme, që adresojnë grupe të ndryshme interesi. Kështu, vetëm në lidhje me zbatimin e PSV-ve janë organizuar:

1. 12 trajnime në çdo qark për **7 profesione** të ndryshme, ku morën pjesë rreth 500 persona të trajnuar nga **9 trajnerë** profesionistë të fushave të ndryshme, të cilët kanë qenë pjesë e hartimit, pilotimit, konsultimit dhe finalizimit të këtyre procedurave.
2. MASH, me kërkesën e vet, në bashkëpunim me ZKKA dhe të mbështetur nga IOM¹⁵, organizuan **7 trajnime** vetëm me stafin pedagogjik, ku morën pjesë rreth **112 persona**. Trajnime të ngjashme, por me stafin shëndetësor, do të vijojnë të zhvillohen në 2013-n.

Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit:

1. Për të përsosur punën e punonjësve të strukturave kundër trafikëve të paligjshme, është realizuar trajnimi me temë “Përdorimi i metodave speciale të hetimit në dokumentin ligjor të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore”, ku morën pjesë **12 punonjës policie** nga strukturat kundër trafikëve.
2. Gjithashtu, është realizuar trajnimi me temë: “Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve për trafikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve”, ku morën pjesë **15 oficerë** të Policisë Gjyqësore, të Seksioneve Kundër Trafikëve të Paligjshme në Qarqet: Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Tiranë.
3. Janë zhvilluar 2 trajnime në bashkëpunim me Prokurorinë dhe Shkollën e Magjistraturës, lidhur me aspektet teorike dhe praktike të trafikimit të personave. Në këto trajnime kanë marrë pjesë **20 punonjës policie**.

¹⁵ IOM ka mbështetur ZKKA-në që prej hapave të pare të hartimit të PSV-ve, e deri më sot.

4. Po kështu, në kuadër të bashkëpunimit të strukturave të policisë me organizatat ndërkombëtare, është realizuar trajnimi me temë "Hetimet pro-aktive", me pjesëmarrjen e **15 punonjësve të policisë**, nga strukturat në qendër dhe në bazë.
5. Në vijim të ngritjes së kapaciteteve të aktorëve antitrafik, gjatë periudhës së raportit, ZKKA, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, në kuadër të Programit të Trajnimit Vazhdues, ka realizuar **19 aktivitete trajnuese**, në të cilat janë trajtuar çështje të trafikimit. Në aktivitetet e zhvilluara janë trajnuar **453 pjesëmarrës** nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, Prokuroria e Krimeve të Rënda, përfaqësues nga Departamenti i Trajnimeve të Policisë dhe nga organizma të tjerë antitrafik. Këto trajnime u mbështetën nga organizata të ndryshme ndërkombëtare

Në trajnimet e zhvilluara u trajtuan tema mbi politikat kombëtare dhe legjislacionin kundër trafikimit në Shqipëri, si dhe mbi sfidat e hasura në praktikën gjyqësore sa i takon trafikimit të personave.

Në vijim të koordinimit dhe bashkëpunimit në kuadër të luftës antitrafik, ZKKA ka sugjeruar që, trajnimi dhe zhvillimi i tematikave antitrafik të jetë pjesë integrale e Programit të Trajnimit Vazhdues 2012- 2015.

2. KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

ZKKA e shtrin veprimtarinë e saj koordinuese si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Kjo zyrë ka një bashkëpunim të qenësishëm dhe të qëndrueshëm, si në rrafshin rajonal, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Sa i përket bashkëpunimit dhe koordinimit me fqinjët dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, theksojmë se ZKKA ka vendosur një bashkëpunim të shkëlqyer me homologët e saj. Përveçse është pjesë e takimeve periodike të Koordinatorëve Kombëtarë të rajonit nëpërmjet ICMPD, MARRI apo procesit të Brdos, ZKKA ka iniciuar edhe marrëveshje bilaterale me fqinjët.

Pas zbatimit me sukses të Marrëveshjes me Greqinë apo Protokollit të Bashkëpunimit me Maqedoninë, ZKKA inicioi hartimin e një protokollit të ngjashëm bashkëpunimi me Kosovën. Nevoja për nënshkrimin e një instrumenti të tillë ishte prezent dhe i një rëndësie të veçantë për shkak të informacioneve të vazhdueshme mbi trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve shqiptarë në Kosovë. Pas një procesi të gjatë diskutimesh dhe negociimesh, më **12.06.2012** u nënshkrua Protokollit shtesë i Bashkëpunimit me Kosovën "Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit, dhe kthimit vullnetar të ndihmuar të viktimave, si dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në veçanti të fëmijëve". Mbetemi ende në pritje të caktimit të personit të kontaktit nga pala kosovare për të filluar zbatimin e këtij Protokollit.

Një partner i rëndësishëm i ZKKA është dhe ICMPD. Kjo organizatë ka qenë një katalizator i rëndësishëm dhe një medium eficient i krijimit të urave të bashkëpunimit në rajon. Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me këtë organizatë ka filluar që prej vitit 2006 e vijon po kështu

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

deri më sot. Në vazhden e aktiviteteve të organizuara prej ICMPD-së do të veçonim trajnimet e mbajtura me profesionistë të ndryshëm nga vendet e rajonit për çështje të trafikimit me qëllim, kryesisht, shfrytëzimin për punë.

Po kaq me vlerë dhe rëndësi është bashkëpunimi me organizata të tilla si UNODC, bashkërisht me të cilën **më 9 dhe 10 maj 2012** u organizua një takim rajonal mbi trafikimin e fëmijëve me qëllim shfrytëzimin për punë.

Një vëmendje të veçantë meriton dhe ndarja e praktikave më të mira edhe me vende përtej rajonit. Kështu, duke vlerësuar PSV-të dhe MKR-në si shembuj pozitivë që duhen ndjekur, ZKKA është kërkuar t'i prezantojë këto dokumente edhe në shtete të tilla, si Ukraina apo Bjellorusia, të cilat janë ende në hapat e para në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër trafikimit.

Siç edhe shihet, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, gjatë periudhës së raportimit, ZKKA ka marrë pjesë në mjaft aktivitete dhe takime të organizuara nga partnerët ndërkombëtarë antitrafik.

Bashkëpunimi me këto organizma për të sjellë në vëmendje identifikimin e problematikave dhe përvojave të secilit vend, ka promovuar një koherencë maksimale midis aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave, ka sjellë një qasje të re lidhur me zhvillimet e fundit në fushë sipas standardeve evropiane në luftën kundër trafikimit të personave, ka përçuar një frymë të re në kuadër të bashkëpunimit, koordinimit dhe eksperiencave të vendeve të ndryshme për të forcuar mekanizmat dhe kapacitetet në luftën kundër trafikimit të personave.

V. ANEKS I

**1. DISA SUGJERIME NË KUADËR TË PËRMIRËSIMIT TË LEGJISLACIONIT
PENAL KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE DHE MBROJTJES SË
VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT**

Instrumentet ndërkombëtarë dhe Kodi Penal Shqiptar

Shqipëria ka ratifikuar në vitin 2002 me ligjin nr. nr.8920, datë 11.07.2002, Protokollin Shtesë (Protokollin i Palermos) të Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar “Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve, 2000”. Ky Protokoll ka shërbyer si model për hartimin e legjislacionit tonë:

- *penalizimin e aktiviteteve që kanë lidhje me trafikimin;*
- *procedurat penale;*
- *masat për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.*

Pas ratifikimit të këtij Protokollin Shtesë lindi nevoja për harmonizimin e Kodit Penal me instrumentet ligjorë ndërkombëtarë të ratifikuara nga Shqipëria. Kjo solli ndryshime në Kodin Penal në vitin 2004 (Ligji nr. 9188, datë 12.2 2004). Si rezultat dispozitat për të luftuar trafikimin e personave pas ratifikimit të Protokollit të Palermos dhe ndryshimeve të vitit 2004 janë enet:

- “Trafikimi i personave” – neni 110/a
- “Trafikimi i femrave” – neni 114/b
- “Trafikimi i fëmijëve” – neni 128/b

Për të siguruar një mbrojtje të posaçme për gratë dhe fëmijët u parashikuan vepra penale të veçanta dhe sanksione më të ashpra (114/b, 128/b)

Vite më pas vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit duhet të ndërtonin një politikë të përbashkët kundër trafikimit. Instrumentet ekzistues preknin vetëm “një aspekt” të fenomenit (aspektin penal). Konventa e Këshillit të Evropës synonte një përjasje më të gjerë: parandalim, mbrojtje e viktimave; ndjekje penale për trafikantët; bashkëpunim.

Trafikimi sipas Konventës së KE-së mund të jetë trafikim i brendshëm ose trafikim ndërkufitar, i lidhur apo jo me krimin e organizuar. Viktimat mund të jenë meshkuj, femra ose fëmijë. Asnjë instrument ndërkombëtar i mëparshëm nuk jep përcaktimin e viktimës së trafikimit dhe formave të mbrojtjes dhe asistencës që duhet të marrë ai/ajo. *Viktimë, sipas Konventës do të nënkuptonte çdo person fizik që është objekt i trafikimit të personave, siç përcaktohet në këtë Konventë.* Asnjë instrument i mëparshëm nuk i jep përparësi themelore respektit për të drejtat e viktimave, mbrojtjes dhe asistencës së viktimave. Shqipëria e ka ratifikuar konventën me Ligjin nr. 9642,

datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës ‘Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore’”.

Praktika shqiptare dhe mekanizmat ndërkombëtare monitoruese kanë kërkuar që nenet mbi trafikimin të jenë në përputhje të plotë me parimet e Konventës së Këshillit të Evropës dhe përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore në këtë Konventë. Mekanizmi monitorues i Konventës, GRETA (*Grup i pavarur ekspertësh*) kanë hartuar vlerësime dhe rekomandime për vendet që kanë ratifikuar këtë Konventë. Vlerësimet dhe rekomandimet e GRETA-s kërkojnë që përkufizimi i trafikimit të përfshijë konceptet që:

- ***Pëlqimi i viktimës për t’u trafikuar me synimin shfrytëzimin, nuk ka asnjë rëndësi kur janë përdorur format shtrënguese të trafikimit;***
- ***Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi do të konsiderohet “trafikim i personave”;***
- ***Trafikimi mund të jetë i brendshëm apo ndërkufitar;***
- ***I organizuar ose jo;***
- ***Të përfshijë të gjithë format e shfrytëzimit.***

Lidhur me ndryshimet dhe shtesat në Kodin Penal¹⁶

Ministria e Brendshme, me iniciativën e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar ka udhëhequr diskutimet për përmirësimin dhe plotësimin e legjislacionit penal që rregullon fushën e luftës kundër trafikimit të personave, dhe gjatë vitit 2012 dhe fillimit të vitit 2013 ky debat ka qenë shumë intensiv. Edhe në ndryshimet e fundit të Kodit Penal të bëra në mars të vitit 2012, pjesë e diskutimeve në Komisionin e Ligjeve ishin edhe sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për përmirësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me trafikimin e personave, propozime të cilat u pranuan në parim, por Komisioni sugjeroi që të rishikohen edhe njëherë me idenë e hartimit të një pakete të plotë ndryshimesh, bazuar edhe në një konsultim më të gjerë.

Komentet dhe propozimet e mëposhtme reflektojnë debatin e zhvilluar kohët e fundit mbi përmirësimin e Kodit Penal, si dhe rekomandimet dhe sugjerimet e partnerëve tanë. Propozimet e bëra synojnë përmbushjen e standardeve minimale të vendosura nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokollat e saj shtesë, ratifikuar me Ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002 dhe Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, ratifikuar me Ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.

Konkretisht propozimet tona vijojnë si më poshtë:

Lidhur me shtimin e një neni në Kodin Penal lidhur me përjashtimin nga dënimi të VT

¹⁶ Versioni i propozuar nga Njësia Antitrafik i përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë - mars 2013

Duhet ndryshuar KP ose shtuar një nen për **përrjashtimin nga dënimi** të viktimave të trafikimit për veprime të paligjshme, të cilat ato mund t'i kenë kryer gjatë shfrytëzimit të tyre si viktima trafikimi. Viktimat e trafikimit për shkak të pozitës së tyre si viktima mund të detyrohen të kryejnë edhe vepra të tjera penale si: kalimi i paligjshëm i kufirit, falsifikimi i dokumenteve, përfshirje në veprimtari kriminale (shitje të lëndëve narkotike, vjedhje deri edhe vrasje). Prandaj sugjerojmë që në KP të shtohet një dispozitë e veçantë në të cilën të parashikohet përjashtimi nga dënimi i viktimave të trafikimit për të gjitha krimet apo kundërvajtjet e kryera si viktima trafikimi (Raporti i GRETA-s – paragrafi 162, 163, 164, 165 dhe rekomandimi nr. 24 referuar nenit 26¹⁷ të Konventës së KE-së “Dispozita e Mosdënimit”). Një variant i mundshëm i përmbajtjes së këtij neni do të ishte:

*Neni _
“Përrjashtimi nga dënimi”*

“Personi i dëmtuar nga veprat penale të trafikimit të personit përfiton përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.”

Lidhur me riformulimin e nenit 110/a të Kodit Penal

Sugjerojmë që për veprën penale “**Trafikimi i personave**” të ketë **vetëm një nen**. Ky sugjerim reflekton zhvillimet më të fundit në drejtim të konsolidimit të kuadrit ligjor kundër trafikimit të personave. Në nenin e riformuluar, **trafikimi i fëmijëve** të jetë rrethanë rënduese duke aplikuar një politikë penale më të ashpër të shprehur në masa më të rënda dënimi.

Në vijim po listojmë disa nga argumentet kryesore se përse dispozita e trafikimit të personave duhet të jetë në një nen të vetëm:

- Në instrumentet më të fundit ndërkombëtare ligjore ku sanksionohet trafikimi i personave, siç është edhe Direktiva e BE-së e datës 5 prill 2011, **trafikimi i personave shihet si dhunim i rëndë i lirive dhe i të drejtave të njeriut**, prandaj kjo dispozitë mendojmë se duhet të qëndrojë në Seksionin VII të Kodit Penal që ka të bëjë me “*Veprat penale kundër lirisë së personit*”;
- **Në të dy Konventat e përmendura më sipër, dispozita e trafikimit të personave jepet në një nen të vetëm dhe nuk bëhet dallim për subjektet që preken**. Në aspektin praktik, parashikimi i trafikimit në tre nene të veçanta ka krijuar vështirësi në kualifikimin ligjor të veprave penale. Termi “person” i përdorur në nenin 110/a “Trafikimi i personave”, i referohet çdo individ, qoftë femër apo mashkull, i rritur apo fëmijë. Ndërsa në praktikë, neni 110/a është interpretuar si i lidhur vetëm me viktimat meshkuj (i rritur mbi 18 vjeç), sepse rastet e tjera janë kualifikuar sipas nenit 114/b për femrat (mbi 18 vjeç), dhe nenit 128/b për fëmijët (femër apo mashkull nga 0-18 vjeç);

¹⁷Neni 26 i Konventës së KE-së - “**Dispozita e mosdënimit** - Çdo Palë, në përputhje me parimet bazë të sistemit të saj ligjor, do të parashikojë mundësinë e mosvendosjes së dënimit për përfshirjen e viktimave në aktivitete të paligjshme, në masën që ato kanë qenë të detyruara ta bëjnë këtë.

- **Koncepti i trafikimit të personave** në legjislacionin tonë (në nenet ekzistuese) nuk është në përputhje të plotë me nenin 3 të Protokollit të Palermos. Kodi nuk sanksionon shprehimisht se *pëlqimi i viktimës për t'u trafikuar me synim shfrytëzimin, nuk merret parasysh kur janë përdorur format shtrënguese të paraqitura në përkufizim;*
- Duhet **standardizuar termat dhe elementët e përdorur në përmbajtjen e nenit për trafikimin e personave**, pasi në Kod nuk ka një përkufizim të qartë për termin juridik të trafikimit të personave dhe vendosja në nene të veçanta krijon akoma më shumë vështirësi në kualifikimin ligjor të veprës penale. Kjo vështirësi vërehet edhe nga zbatuesit e ligjit në praktikë në kuptimin dhe interpretimin e elementëve të veprës penale të trafikimit të personave;
- Lidhur me **elementë të veçantë të veprës së trafikimit të personave**, GRETA (Grupi i Ekspertëve për Monitorimin e Zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës) në raportin e tij për Shqipërinë në datë 02/12/2011 sugjeron rishikimin e disa termave si *“fshehja”, “mashtrimi”, “përfitimi nga gjendja shoqërore”, “vënia në përdorim ose transplantimi i organeve”,* etj., të dispozitës së trafikimit të personave. Qartësimi i termave dhe koncepteve të përdorura në Kodin Penal për elementë të veçantë të veprës penale do të na ndihmonte për të standardizuar edhe termin e saktë që duhet të përdorim për vetë fenomenin, problem i krijuar edhe për shkak të vështirësive në përkthimin dhe kuptimin e termave të tillë si: *trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i personave, trafikimi në njerëz etj.*

Duke u bazuar në sa më sipër, sugjerojmë që neni 114/b dhe neni 128/b të shfuqizohen dhe të ketë një nen të vetëm për trafikimin e personave - neni 110/a, për të cilin propozojmë këtë formulim:

Neni 110/a
“Trafikimi i personave”

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, strehimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës, shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, shpërdorimit të detyrës, përfitimit nga gjendja shoqërore apo fizike, dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin, që përfshin shfrytëzimin e prostitucionit, shfrytëzimin seksual, shfrytëzimin për punë, lypjen, shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikën e ngjashme me skllavërinë, heqjen ose transplantimin e organeve, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Pëlqimi i personit të dëmtuar për shfrytëzimin e synuar apo të realizuar, të parashikuar në paragrafin (1) të këtij neni, nuk do të merret parasysh kur është përdorur ndonjë nga mjetet e parashikuara në këtë paragraf.

Kur kjo veprë kryhet ndaj një fëmije do të konsiderohet “trafikim i personave” edhe kur nuk përdoren mjetet e parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni dhe dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda për shëndetin ose me dashje apo nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shpërdorimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me ¼ e dënimit të dhënë.

Komente për elementë të veçantë në riformulimin e nenit 110/a

- Figura e veprës penale të trafikimit të personave përmban **tre elemente** që janë: **veprimet** (*Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, strehimi, fshehja ose pritja e personave*) **mjetet** (*kërcënimet, përdorimit të forcës, shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, shpërdorimit të detyrës, përfitimt nga gjendja shoqërore apo fizike, dhënies ose marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër*) **dhe qëllimi i shfrytëzimit** (*shfrytëzimin e prostitucionit, shfrytëzimin seksual, shfrytëzimin për punë, lypjen, shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen ose transplantimin organeve*). Tek elementi “veprimet” është shtuar “**shitja**”, dhe “fshehja” është zëvendësuar me fjalën “**strehimi**” si term më i saktë në përkthimin e nenit 3 të Protokollit të Palermos, dhe është riformuluar paragrafi i parë në një mënyrë të qartë. Tek qëllimi i shfrytëzimit është shtuar “**lypja**” dhe janë riformuluar shprehjet “*të vënies në përdorim ose të transplantimit të organeve*” duke e zëvendësuar me shprehjen “*heqjen ose transplantimin organeve*” ;
- Në **paragrafin e parë**, në rreshtin e fundit është shtuar shprehja “*si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë*”. Ky plotësim është i domosdoshëm dhe zgjidh një problematikë shumë të madhe të krijuar në praktikë lidhur me konceptin e trafikimit të brendshëm. Me vendosjen e kësaj shprehje thjeshtësohet kuptimi i trafikimit të personave si një krim jo vetëm Transnacional. (Për më shumë lutemi referojuni pikës 5 të Komentarit të Konventës së KE-së);
- **Paragrafi i dytë** sqaron se **pëlqimi i viktimës** (shprehja e vullnetit), element i cili ka munguar në përmbajtjen e nenit ekzistues, në draftin e ri vendoset sipas nenit 4 pika b të Ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 për ratifikimin e Konventës së KE-së ; (Për më shumë, lutemi, referojuni pikës 97 të Komentarit të Konventës).
- **Paragrafi i tretë** sqaron rastin e **trafikimit të fëmijëve** duke sjellë të njëjtin formulim që parashikon Konventa e KE-së – neni 4 pika c dhe d, duke e konsideruar këtë rast si rrethanë rënduese shoqëruar edhe me masa më të rënda dënimi;
- Lidhur me konsiderimin si rrethanë rënduese edhe faktin kur personi i dëmtuar është femër mendojmë se kjo pikë duhet të hiqet, për faktin se tashmë koncepti modern për trafikimin është se viktimë e trafikimit mund të jetë kushdo, femër apo mashkull, i rritur apo fëmijë, si dhe format e shfrytëzimit nuk janë më vetëm format klasike të shfrytëzimit seksual, por edhe forma të tjera si p.sh. “*Shfrytëzimi për punë në bujqësi dhe ndërtim*”, ku ndoshta më të ekspozuar janë meshkujt. Prandaj edhe masat ndëshkuese duhet të jenë njësoj si për trafikimin e femrave ashtu edhe për atë të meshkujve. Ndërsa në rastin e fëmijëve duhet bërë një diferencim, ashtu siç kërkohet edhe në Konventë, për vetë faktin e vulnerabilitetit të fëmijëve. Instrumentet ndërkombëtare kërkojnë standarde të ndryshme për mënyrën e adresimit të nevojave për mbrojtje dhe në këtë rast merret në konsideratë edhe elementi

gjinnor i viktimave të trafikimit për shkak të nevojave specifike që ato kanë për shërbime të ndryshme.

Lidhur me plotësimin e detyrimeve të nenit 19 “Kriminalizimi i përdorimit të shërbimeve të një viktime” të Konventës së KE-së

Në zbatim të nenit 19 të Konventës së KE-së kërkohet që palët nënshkruese të marrin në konsideratë masa legjislative dhe masa të tjera sipas nevojës për të përcaktuar si vepra penale, sipas legjislacionit të saj të brendshëm, përdorimin e shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit, siç referohen në nenin 4 paragrafi “a” i kësaj Konvente, me dijeninë që personi është viktimë e trafikimit të personave.

Për sa më sipër sugjerojmë shtimin e një neni të ri (110/b), i cili të renditet menjëherë pas nenit 110/a me këtë formulim:

Neni 110/b

Përdorimi i shërbimeve të personave të trafikuar

Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të personave të trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni se personi është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër kur kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Lidhur me zbatimin e nenit 20 të Konventës së KE-së

Sugjerojmë që edhe për dënimin e përdorimit të shërbimeve të një viktime trafikimi të ketë një nen të veçantë, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Konventës së KE-së të ketë një nen të veçantë. Duke u mbështetur kryesisht në përmbajtjen e nenit të Konventës së KE-së propozojmë këtë formulim për nenin e shtuar 110/c:

Neni 110/c

*Veprime me dokumentet e udhëtimit dhe identitetit
për mundësimin e trafikimit të personave*

Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumenteve të identitetit, pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit, apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, me qëllim mundësimin e trafikimit të personave, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet me qëllim mundësimin e trafikimit të fëmijëve, në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin e identitetit, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Lidhur me ndryshimet e neneve 114 dhe 114/a të Kodit Penal

Dispozitat e trafikimit, shpesh në praktikë konkurrojnë me nenin 114/a “*Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese*”.

Neni 114/a është riformuluar në Kodin Penal me ndryshimet e vitit 2001, kohë në të cilën nuk ekzistonin ende dispozitat për trafikimin e personave, duke mbuluar edhe disa elementë të trafikimit të personave. Me ndryshimet e KP në vitin 2004, pikat 1, 4 dhe 5 e nenit 114/a, rezultojnë të njëjtë me elementët e parashikuar në dispozitat për trafikimin e personave - Nenet 110/a, 114/b dhe 128/b të KP. Këto elementë kanë krijuar shumë vështirësi edhe në praktikë në kualifikimin ligjor të veprave penale.

Në disa vende perëndimore ka një mendim më të avancuar për ta klasifikuar si trafikim të personave çdo rast të shfrytëzimit të prostitucionit. Në fakt, shfrytëzimi i prostitucionit të tjerëve përmendet shprehimisht në nenin 3 të Protokollit të Palermos dhe në nenin 4 të Konventës së KE-së – si një nga format e shfrytëzimit që ka të bëjë me përkufizimin e trafikimit të personave. Për më tepër njohja e personave të dëmtuar, nga shfrytëzimi i prostitucionit si viktima trafikimi, do të siguronte një mbrojtje më të mirë dhe bashkëpunimin e tyre me drejtësinë. Moskualifikimi i drejtë ligjor i veprave penale krijon pasoja të pariparueshme për të dëmtuarit, në veçanti për viktimat e trafikimit. Raporti i GRETA-s përmend edhe faktin se sanksionet për të dy nenet janë pak a shumë të ngjashme për sa i përket dënimit me burgim.

Për të shmangur këtë përplasje dhe duke u mbështetur në argumentet e përmendur më sipër sugjerojmë që neni 114/a të shkrihet me nenin 114 të KP “*Shfrytëzimi i prostitucionit*”, duke hequr elementët e ngjashëm me dispozitën e trafikimit që ekzistojnë në nenin 114/a dhe elementët e tjerë të konsiderohen si rrethanë rënduese në vazhdim të nenit 114. Një version i mundshëm i riformulimit të nenit 114 është:

*Neni 114
Shfrytëzimi i prostitucionit*

Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, ose kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore ose publike, duke përfituar nga raportet zyrtare dënohet me burgim nga shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet burgim.

Lidhur me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale

Fillimisht konstatojmë se për viktimat e krimit në përgjithësi, dhe **viktimat e trafikimit** në veçanti në K.Pr.P nuk janë parashikuar dispozita të cilat marrin në **mbrojtje pozitën e tyre në procesin penal**. Sipas K.Pr.P viktima e trafikimit shfaqet në procesin penal me **statusin e dëshmitares së një rëndësie të veçantë, por ato nuk legjitimohen si palë në procesin penal**. Veprat penale të trafikimit janë vepra që ndiqen kryesisht dhe në këtë rast e dëmtuara (viktima e trafikimit) nuk mund të paraqitet si palë në proces siç paraqitet i dëmtuari akuzues për veprat penale të parashikuara nga neni 59 i K.Pr.P. Duke u mbështetur edhe në praktikën e deritanishme, rezulton se viktima e trafikimit, duke mos qenë e përfaqësuar në proces, nuk është e mbrojtur si duhet, pavarësisht garancive të tjera ligjore. Zgjidhja do të ishte që të parashikohen dispozita të

veçanta në K.Pr.P për përfaqësimin e viktimës (interesave të viktimës) nga persona të tretë, përfaqësues ligjorë të viktimës, avokatë, punonjës të organizatave të ndryshme etj., dhe kjo të realizohet brenda procesit penal, edhe në rastin kur viktima nuk pranon të dëshmojë. Duhet rishikuar dispozitat e K.Pr.P që rregullojnë aksesin e të dëmtuarës në drejtësi (në këtë rast viktima së trafikimit, por jo vetëm) me qëllim që ai/ajo (i dëmtuari/e dëmtuara) të bëhet palë aktive në proces në funksion të mbrojtjes së interesave dhe rehabilitimit të saj.

Edhe në drejtim të sigurimit të instrumenteve efektiv për **kompensimin e viktimës së trafikimit** ka nevojë për përmirësime ligjore. Krahas krijimit të një skeme shtetërore për kompensimin e viktimave të trafikimit duhen ndryshuar dhe plotësuar edhe dispozitat e K.Pr.P për ngritjen e padisë civile në procesin penal dhe gjykimin e saj brenda këtij procesi. Ky është edhe rasti i vetëm ku, sipas K.Pr.P nenet 58-68, viktima e trafikimit mund të marrë pjesë si palë në proces, nëpërmjet padisë civile në procesin penal, për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit.

Për çështjen e kompensimit të viktimave të trafikimit, Raporti i GRETA-s përmend edhe problemet e hasura në zbatimin e ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (raporti i GRETA-s paragrafët 171, 172, 174, 128 dhe rekomandimi nr. 17). Megjithatë, ne mbetemi të mendimit se, krahas skemës shtetërore të kompensimit, zgjidhja më e drejtë dhe më efikase do të ishte **gjykimi i padisë civile brenda procesit penal** dhe për këtë sugjerojmë që rregullimi të bëhet në K.Pr.P.

Direktivat e BE-së të datës 5 prill 2011 (paragrafi 13 dhe neni 17) rekomandojnë dhe inkurajojnë **përdorimin e aseteve të konfiskuara për mbështetjen e viktimës** së trafikimit për mbrojtje përfshirë edhe kompensimin. Lidhur me kompensimin e viktimave të trafikimit ka disa eksperiencë pozitive edhe në vendet e BE-së si p.sh. Austria - Pas një studimi të zhvilluar për këtë çështje në nëntor 2010 është miratuar një paketë e ligjore “Criminal Law Competence Package”, e cila ka për qëllim zbatimin e urdhrave për konfiskimin e aseteve dhe kompensimin e viktimave të trafikimit. Në vitin 2011, MD e Austrisë ka angazhuar disa Prokurorë të veçantë për çështjet e konfiskimit të aseteve të përfituara nga veprat e trafikimit me qëllim përdorimin e tyre edhe për kompensimin e viktimave të trafikimit.

Shqetësim tjetër përbën edhe mungesa e parashikimeve të qarta në K.Pr.P për **dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit në mënyrë të pakushtëzuar**. Në praktikë kjo është zgjidhur duke iu referuar direkt akteve ndërkombëtare ose me instrumente të tjera si: Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit (MKR) dhe së fundi edhe me VKM Nr. 582 datë 27.07.2011 “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/viktimave të Mundshme të Trafikimit”. Megjithatë, mendojmë se një rregullim i tillë duhet të bëhet me një dispozitë edhe në K.Pr.P.

Sipas rekomandimeve të GJKR (raporti i ZKKA maj 2009) duhet të ndryshohet K.Pr.P., përkatësisht neni 158 të K.Pr.P. Nga praktika gjyqësore është konstatuar se, në kushtet kur viktimat e trafikimit janë konsideruar si të dëmtuara nga vepra penale, organet e zbatimit të ligjit, në përgjithësi, nuk kanë aplikuar të drejtën e tyre sipas nenit 158 të K.Pr.P. Por në të vërtetë, në mënyrën se si është aktualisht e formuluar dispozita e mësipërme krijon paqartësi lidhur me **të drejtën e të dëmtuarve për të mos dhënë deklaratime** në fazën e hetimeve paraprake apo

dëshmi gjatë gjykimit, në rastet kur deklarojnë se kanë bashkëjetuar apo kanë lidhur martesë me tutorët e tyre.

Komente për ndryshime të tjera ligjore

Lidhur me krijimin dhe lehtësimin e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit duhet rishikuar edhe legjislacioni për taksat dhe tatimet në RSH, i cili parashikon një sërë detyrimesh për palët që marrin pjesë në proces. Këto detyrime kanë krijuar probleme dhe pengesa për aksesin e viktimave të trafikimit në drejtësi dhe për këtë kërkohet që të përmirësohen aktet e mëposhtme:

- **Tarifa për shërbimin e administratës gjyqësore** në vlerën 12.000 lekë – Udhëzimi nr.13/2009 i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë;
- Viktima duhet të paguajë **tarifën prej 1% të vlerës së objektit të padisë dhe 3% të vlerës për ekzekutimin e vendimit** – Ligji 8977/2002, Lidhja 5 “Për sistemin e Taksave në RSH”.

Propozimi për hartimin e një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit të personave

Nisur nga nevoja për të patur një kuadër ligjor sa më të plotë për luftën kundër trafikimit të personave, i cili të jetë edhe në përputhje me standardet dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, kohët e fundit është hedhur ideja e hartimit të një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit të personave. Disa argumente mbështetës për hartimin e një ligji të tillë janë:

- Një ligj i veçantë për trafikimin do të na jepte mundësinë që **në një akt të vetëm të bëhet një rregullim i plotë për të gjithë fushën** e luftës kundër trafikimit të personave (LKTP);
- Ka edhe vende të tjera që kanë një ligj të veçantë për LKTP siç është rasti i Irlandës, Greqisë dhe Bullgarisë. Për më tepër masa të tilla inkurajohen edhe nga Direktivat e BE-së të datës 5 prill 2011, të cilat adoptojnë një përfaqje të plotë të integruar, të bazuar tek të drejtat e njeriut dhe me fokus të veçantë mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
- Me një ligj të tillë bëhet një organizim më i mirë dhe përcaktim më i qartë i të gjithë masave ligjore dhe institucionale për LKTP dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit:
 - Përkufizim dhe kuptim më i qartë dhe i standardizuar i të gjitha termave të përdorur në instrumentet dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë fushë;
 - Përcaktimi i të gjitha strukturave të përfshira në LKTP si në nivel qendror dhe vendor;
 - Rishikimi i rolit të Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Njësisë Antitrafik;
 - Rishikimi i mundësisë së ngritjes së një funksioni të ri, të pavarur, i zgjedhur nga Parlamenti “Raporteri Kombëtar”, i cili do të kishte për detyrë gjenerimin e raporteve për situatën e trafikimit në vend, tendencat e trafikimit, efektin e politikave shtetërore për të luftuar trafikimin, prodhimin e statistikave cilësore dhe sasiore për shkallën e përhapjes së fenomenit, llojet e trafikimit, grupet e prekura etj. (shembuj nga vende të ndryshme edhe të BE-së si Holanda, Çekia, Portugalia etj.). Ngritja e një funksioni të tillë rekomandohet edhe nga Direktiva e BE-së e datës 5 prill 2011 (neni 19);
 - Parashikimi me ligj i mekanizmave për adresimin e fenomenit, në veçanti mekanizmin kombëtar të referimit për viktimat e trafikimit, si dhe ngritjen e skemës shtetërore të kompensimit të viktimave të trafikimit etj.;

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

- Dhënia e një statusit “viktimë trafikimi” personave të dëmtuar nga vepra penale e trafikimit;

Plotësimi i detyrimeve ndërkombëtare për marrjen e masave të ndryshme ligjore për adresimin e fenomenit në veçanti Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.

VI. ANEKS 2

1. Ndërgjegjësimi dhe zgjerimi i rrjetit të aktorëve antitrafik

Gjatë periudhës së raportimit, ZKKA ka organizuar dhe marrë pjesë në një sërë aktiviteteve koordinuese për parandalimin e trafikimit të personave të organizuara në vend.

Kështu, gjatë muajit Maj dhe Qershor, ZKKA së bashku me Organizatën “Të Ndryshëm & Të Barabartë” dhe në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit kundër Diskriminimit dhe Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik ndërmorën fushatën e sensibilizimit “Respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri – t’i japim fund stigmës”. Fushata u shtri në tre qytete, Tiranë, Vlorë dhe Elbasan dhe targetoi tre grupe kryesore: nxënësit e shkollave (4 shkolla të mesme në çdo qytet), komunitetet e ndryshme dhe punëdhënësit.

ZKKA mori pjesë në aktivitetin e Koalicionit Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve (BKTF) në kuadër të Ditës së Fëmijëve, si ditë sensibilizuese për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre, me pjesëmarrjen e rreth **200 fëmijëve** dhe përfaqësuesve të autoriteteve dhe misioneve diplomatike.

Me rastin e **18 Tetorit**, Ditës Evropiane kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Ministria e Brendshme, nëpërmjet Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit në Njerëz dhe Njesisë Antitrafik, organizoi një aktivitet ndërgjegjësuës për përpjekjet dhe arritjet në fushën e luftës kundër trafikimit të personave, në bashkëpunim me Prefekturën e Tiranës, Fakultetin e Drejtësisë dhe Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik. Bashkë-organizimi i një eventi të tillë me aktorë të rëndësishëm të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, i dha një frymë të re bashkëpunimit institucional mes qeverisjes qendrore, qarqeve akademike dhe organizmave të tjerë shtetërorë dhe jo shtetërorë, sidomos për çështje kaq të ndjeshme dhe të prekshme, siç është rritja e të drejtave të viktimave të trafikimit, duke synuar të luftojë stigmën e vazhdueshme dhe të egër me të cilën ato përballen gjatë procesit të tyre të riintegrimit në shoqërinë shqiptare.

2. Ngritja e koordinuar e kapaciteteve të aktorëve antitrafik në aktivitetet ndërkombëtare

Periudha e raportimit ka qenë një periudhë shumë e ngjeshur me aktivitete të ngritjes së kapaciteteve. Trajnime me përfshirje të gjerë të të gjithë aktorëve përgjegjës për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit janë zhvilluar gjatë periudhës në raportim.

Koordinatori Kombëtar dhe përfaqësues nga policia, prokuroria dhe gjykata morën pjesë në seminarin “BE në Luftën kundër Trafikimit dhe Krimit të Organizuar”, organizuar në Sarajevë, Bosnjë Hercegovinë nga Ministra e Sigurisë e Bosnjës dhe Hercegovinës, Komisionin Evropian dhe Këshilltari Rajonal Francez për Çështjet e Trafikimit të Personave në Evropën Juglindore. Qëllimi i seminarit të zhvilluar në datat **17-18 prill 2012**, ishte të transmetonte njohuri mbi

*Raport për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave
Janar-Dhjetor 2012*

legjislacionin dhe praktikën lidhur me policinë dhe bashkëpunimin në çështjet e krimit dhe doganave për rritjen e efikasitetit të hetimit dhe dënimit të trafikimit të fëmijëve dhe rrjeteve kriminale ndërkufitare.

ZKKA dhe UNODC organizuan, në **9 dhe 10 Maj 2012**, konferencën rajonale “Lançimi i Raportit Rajonal të UNODC për Trafikimin e Fëmijëve me Qëllim Shfrytëzimin Seksual”. Raporti analizonte situatën e pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë. Raporti synonte të sensibilizonte agjencitë antitrafik për dokumentimin më të mirë të trafikimit të fëmijëve, dhe të jepte mesazhin që trafikimi i fëmijëve nuk mund të zgjidhet pa adresuar gjithashtu çështje të pabarazisë gjinore, varfërisë dhe migrimit të pasigurt.

Pjesëmarrja e dy koordinatorëve të ZKKA në seminarin "Profilet e Trafikimit: Format, Grupet & Politikën" të organizuar nga Golda Meir Mount Carmel International Training Center (MCTC) në Haifa, Izrael nga **14 deri 24 Maj**, shërbeu për shkëmbimin e eksperiencave mes vendeve për luftën kundër trafikimit të personave. Pjesëmarrja e zgjeruar në këtë event nga vende të ndryshme, solli edhe njëherë në vëmendje praktikën më të mira, sa i takon luftës kundër trafikimit të personave, dhe sidomos, luftës kundër shfrytëzimit të punës.

Në kuadër të prezantimit të PSV-ve dhe MKR-së si praktika të mira për t'u ndjekur, ZKKA mori pjesë më **15 nëntor 2012**, në Kiev, Ukrainë, në Konferencën “Diskutimi Rajonal i Koordinatorëve Kombëtarë në përgjigje të trafikimit të qenieve njerëzore.

Meqenëse parandalimi është një nga shtyllat kryesore të luftës kundër trafikimit të personave, në kuadër të shkëmbimit të përvojave dhe marrjes së eksperiencave, një koordinator i ZKKA mori pjesë në takim “Adresimi i shkaqeve të trafikimit të qenieve njerëzore”, zhvilluar në datat **3-5 dhjetor 2012**, në Sofje, Bullgari.

Komisioni Evropian/Drejtorja e Përgjithshme për Zgjerimin (TAIEX Instrument) zhvilloi një seminar/trajnim me temë “Lufta kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” organizuar nga Akademia Evropiane e Ligjit (ERA) në **datat 6-7 dhjetor 2012**, në Vienë, Austri. Tematika e këtij seminary ishte njohja me zhvillimet e fundit në fushë, standardet evropiane në luftën kundër trafikimit të personave, bashkëpunimi në këtë fushë, eksperiencat e vendeve anëtarë, si dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit etj.

ZKKA mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Zhvillimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Mbrojtjen dhe Asistencën e Viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, mbajtur në Minsk, Bjellorusi, në datat **12-13 dhjetor 2012**, në të cilën shpallosi arritjet dhe praktikën më të mira të ZKKA-së, sa i takon luftës kundër trafikimit të personave dhe bashkëpunimit mes aktorëve antitrafik.